Informacioni i modelit siç ruhet në bazën e të dhënave të produktit mund të arrihet duke hyrë në uebfaqen vijuese dhe duke kërkuar identifikuesin e modelit tuaj (*) emërtimin e energjisë foundon:https://eprel.ec.europa.eu/

PARALAJMËRIM: Vlerat e konsumit janë të zbatueshme për rastet kur lidhja e rrjetit wireless është e fikur.

4.1 Instalimi

- Kërkojini agjentit më të afërt të autorizuar të shërbimit për instalimin e produktit tuaj.
- Përgatitja e vendit dhe instalimeve elektrike, të furnizimit me ujë dhe largimit të ujit të përdorur në vendin e instalimit, është nën përgjegjësinë e blerësit.
- Sigurohuni që tubat e ngakimit dhe shkarkimit të ujit dhe gjithashtu kordoni elektrik nuk janë të palosur, të shtypur ose të thërrmuar gjatë shtyrjes së produktit në vendin e tij pas procedurave të instalimit apo pastrimit.
- Sigurohuni që instalimi dhe lidhjet elektrike të produktit të bëhen nga shërbimi i autorizuar. Prodhuesi nuk do të mbajë përgjegjësi për dëmtime që mund të bëhen nga procedura të kryera nga persona të paautorizuar.
- Përpara instalimit, kontrolloni me sy nëse produkti ka ndonjë defekt të dukshëm. Nëse po, mos e instaloni. Produktet e dëmtuara shkaktojnë rreziqe për sigurinë tuaj.

4.1.1 Vendi i përshtatshëm i instalimit

- Vendoseni produktin mbi një dysheme të fortë dhe të niveluar. Mos e vendosni mbi qilim të trashë ose sipërfaqe të ngjashme.
- Kur makina larëse dhe makina tharëse vendosen mbi njëra tjetrën, pesha e tyre totale - kur është e ngarkuar - shkon në 180 kilogram. Vendoseni produktin në një sipërfaqe të sheshtë dhe të fortë që ka kapacitet mbajtës të mjaftueshëm!
- Mos e vendosni produktin mbi kordonin elektrik.
- Mos e instaloni produktin në mjedise ku temperatura bie nën 0 ºC.
- Sugjerohet të lihet hapësirë anash pajisjes për të pakësuar dridhjet dhe zhurmën
- Mbi një dysheme të shkallëzuar, mos e vendosni produktin pranë cepit ose mbi një platformë.
- Mos vendosni burime nxehtësie si soba, hekura, furra, etj. mbi lavatriçe dhe mos i përdorni ato mbi pajisje.


4.1.2 Heqja e përforcimeve të paketimit



Anoni makinerinë nga ana e pasme për të hequr paketimet përforcuese. Hiqini paketimet përforcuese duke tërhequr shiritin. Mos e bëni vetëm këtë punë.

4.1.3 Heqja e kyçjeve të transportit

1 Lironi të gjitha vidat me një çelës të përshtatshëm derisa të rrotullohen lirshëm.
2 Hiqni vidat e sigurisë të transportit duke i rrotulluar pak.
3 Vendosni kapakët plastikë në qesen ku është manuali i përdoruesit në hapësirat në panelin e pasmë.




	KUJDES: Hiqini bulonat e sigurisë së transportit përpara vënies në punë të makinës larëse! Në rast të kundërt, produkti do të dëmtohet.
	Ruajini bulonat e sigurisë së transportit në një vend të sigurt që ti ripërdorni kur makina larëse duhet të lëvizet sërish në të ardhmen.
	Instaloni vidat e sigurisë të transportit në rend të kundërt të procedurës të çmontimit.
	Mos e lëvizni asnjëherë produktin pa vendosur në vend siç duhen bulonat e sigurisë së transportit!

4.1.4 Lidhja e furnizimit me ujë

Presioni i furnizimit me ujë që kërkohet për të vënë në punë produktin është midis 1 dhe 10 (0.1 – 1 MPa). Është e nevojshme që të keni 10 - 80 litra ujë të rrjedhshëm në një minutë nga rubineti i hapur plotësisht që makineria të punojë normalisht. Vendosni një valvul që ul presionin nëse presioni i ujit është i lartë.

KUJDES: Modelet me një hyrje të vetme të ujit nuk duhet të lidhen me rubinetin e ujit të nxehtë. Në një rast të tillë rrobat do të dëmtohen ose produkti do të kalojë në metodën e mbrojtur dhe nuk do të punojë.

KUJDES: Mos përdorni tuba uji hyrës të vjetër apo të përdorur për produktin e ri. Mund të krijojë njolla mbi rrobat tuaja.




1 Shtrëngoni vidat e tubit me dorë. Mos përdorni asnjëherë mjet për të shtrënguar vidat.

2 Kur të jetë bërë lidhja e tubit, kontrolloni nëse ka probleme rrjedhjeje në pikat e lidhjes duke i hapur rubinetet plotësisht. Nëse ka ndonjë rrjedhje, mbyllni rubinetin dhe hiqni vidën. Shtrëngoni sërish vidën me kujdes pasi të keni kontrolluar mbylljen. Për të mos lejuar rrjedhje uji dhe dëmtimet që vijnë si rezultat, mbajini rubinetet të mbyllur kur nuk e përdorni produktin.

4.1.5 Lidhja e tubacionit të kullimit

- Lidheni fundin e tubit të shkarkimit direkt me direkt me shkarkimin e ujërave, lavamanin ose vaskën.

KUJDES: Shtëpia juaj do të përmbytet nëse markuçi del nga vendi gjatë shkarkimit të ujit. Për më tepër, ekziston rreziku i përvëlimit për shkak të temperaturave të larta të larjes. Për të mos lejuar situata të tilla dhe për t'u siguruar që makineria të kryejë pa probleme proceset e futjes dhe shkarkimit të ujit, shtrëngojeni fort tubin e shkarkimit.



- Lidheni tubin e kullimit në një lartësi minimale prej 40 cm dhe një lartësi maksimale prej 100 cm.
- Në rastin kur tubi i kullimit ngrihet pasi ka qenë në nivelin e dyshemesë ose afër tokës (më pak se 40 cm mbi tokë), shkarkimi i ujit bëhet më i vështirë dhe rrobat mund të dalin shumë të njoma. Prandaj, merrni parasysh lartësitë e treguara në figurë.


- Për të mos lejuar ujin e përdorur të kthehet përsëri në makineri dhe për të siguruar shkarkim të lehtë, mos e zhytni fundin e tubit në ujin e shkarkuar ose mos e futni në shkarkim më thellë se 15 cm. Nëse është shumë i gjatë, priteni.
- Fundi i tubit nuk duhet të jetë i palosur, nuk duhet të jetë i shtypur dhe tubi nuk duhet të jetë i bllokuar midis shkarkuesit dhe makinerisë.
- Nëse gjatësia e tubit është e pamjaftueshme, përdoreni duke i shtuar një tub shtesë origjinal. Gjatësia e tubit nuk mund të jetë më e gjatë se 3.2 m. Për të shmangur problemet me rrjedhjen e ujit, lidhja midis tubit të shtuar dhe tubit të shkarkimit duhet të mbërthehet mirë me një morsetë të përshtatshme që të mos rrjedhë.

4.1.6 Rregullimi i shputave

KUJDES: Me qëllim që të sigurohemi që produkti punon pa zhurma dhe pa dridhje, ai duhet të qëndrojë në nivel dhe i balancuar me këmbët e tij. Balanconi makinerinë duke rregulluar këmbët. Përndryshe, produkti mund të lëvizë nga vendi i tij dhe të shkaktojë shtypje dhe probleme me dridhjen.

KUJDES: Mos përdorni asnjë mjet për të liruar vidat bllokuese. Në të kundërt, ato do të dëmtohen.

1 Lironi me dorë vidat bllokuese të këmbëve.
2 Rregulloni këmbët derisa produkti të qëndrojë në një mënyrë të qëndrueshme dhe të balancuar.
3. Shtrëngoni përsëri me dorë të gjitha vidat e bllokimit.



4.1.7 Lidhja elektrike

Lidheni produktin me një prizë të tokëzuar të mbrojtur nga një siguresë 16 A. Kompania jonë nuk do të mbajë përgjegjësi për ndonjë dëmtim që mund të kryhet kur produkti përdoret pa tokëzim në përputhje me rregulloret lokale.

- Lidhja duhet të jetë në përputhje me rregulloret kombëtare.
- Lidhjet për qarkun e prizës elektrike duhet të jenë të mjaftueshme sa të plotësojnë kërkesat e pajisjes. Rekomandohet përdorimi i një automati GFCI.
- Spina e kordonit elektrik duhet të arrihet lehtësisht pas instalimit.
- Nëse vlera aktuale e siguresës apo çelësit në shtëpi është më pak se 16 Amps, merrni një specialist elektrik të kualifikuar për të instaluar një siguresë 16 Amp.
- Voltazhi i përcaktuar në pjesën "Specifikimet teknike" duhet të jetë i barabartë me voltazhin e energjisë tuaj.
- Mos bëni lidhje nëpërmjet kordonëve zgjatues apo me shumë priza.

KUJDES: Kordonët elektrikë të dëmtuar duhet të zëvendësohen nga Agjentët e Autorizuar të Shërbimit.

4.1.8 Përdorimi fillestar



Para se të filloni ta përdorni produktin sigurohuni që të jenë bërë përgatitjet të cilat janë në përputhje me "Udhëzimet e Rëndësishme të Sigurisë dhe Mjedisit" dhe udhëzimet në pjesën "Instalimi".
Për ta bërë gati produktin për të larë rroba, kryeni si punë të parë programin Pastrim Kazani. Nëse ky program nuk është i disponueshëm në makinerinë tuaj, përdorni metodën që përshkruhet në pjesën 4.4.2.

Përdorni një kundër-gëlqeror të përshtatshëm për makinat larëse.

Një sasi uji mund të ketë mbetur në produkt për shkak të proceseve të kontrollit të cilësisë në prodhim. Kjo nuk është e dëmshme për produktin.

4.2 Përgatitja

4.2.1 Klasifikimi i rrobave për larje

- Klasifikojini rrobat sipas llojit të materialit, ngjyrës dhe shkallës së ndotjes dhe temperaturës së lejuar të ujit.
- Ndiqini gjithmonë udhëzimet e dhëna në etiketat e kujdesit të teshave.

4.2.2 Përgatitja e rrobave për larje

- Rrobat me pjesë metalike si tela të brendshëm, tokëza rripash ose kopsa metalike do ta dëmtojnë produktin. Hiqini pjesët metalike ose lajini këto rroba duke i vendosur ato në një çantë për larje apo këllëf.
- Hiqni nga xhepat të gjithë objektet e tilla si monedhat, stilolapsat dhe kapëset metalike të letrave, kthejini xhepat së prapthi dhe pastrojini. Objekte të tilla mund ta dëmtojnë produktin ose të shkaktojnë probleme me zhurmën.
- Rrobat me përmasa të vogla, të tilla si çorapet e bebeve dhe çorapet e najlonit, vendosini në një çantë për larje ose këllëf.
- Vendosini perdet brenda pa i ngjeshur. Hiqni pajimet mbajtëse të perdeve.
- Mbërtheni zinxhirët, qepni kopsat e liruara dhe rregulloni të grisurat dhe të çarat.
- Produktet me etiketën "Lahet me makinë larëse" ose "Lahet me dorë" lajini vetëm me një program të përshtatshëm.
- Mos i lani rrobat me ngjyrë dhe ato të bardha bashkë. Veshjet e reja, të errëta të pambukta lëshojnë shumë bojë. Lajini këto rroba më vete.
- Njollat e forta duhet të trajtohen siç duhet para larjes. Nëse jeni të pasigurt, verifikojeni në një pastrim kimik.
- Përdorni vetëm ngjyrues/ndryshues ngjyre dhe agjentë zhgëlqerëzues të përshtatshëm për makinë larëse. Ndiqni gjithmonë udhëzimet në paketim.
- Lajini pantallonat dhe rrobat delikate të kthyera së prapthi.
- Artikujt e përbërë prej leshi angore ruajini në ngrirës për disa orë përpara larjes. Kjo do të ulë rënien e qimeve.
- Rrobat që janë ndotur me materiale të tilla si miell, pluhur gëlqereje, qumësht pluhur, etj. duhet të shkunden mirë përpara se të futen në pajisje. Këto tymra dhe pluhura në rroba mund të grumbullohen në pjesët e brendshme të pajisjes dhe me kalimin e kohës mund të shkaktojnë dëme.

Këshilla për ruajtjen e energjisë dhe ujit

Informacioni në vijim do t'ju ndihmojë që ta përdorni pajisjen në mënyrë ekologjike dhe efikase në lidhje me energjinë.

- Përdoreni pajisjen me kapacitetin më të lartë të ngarkesës së lejuar nga programi që keni përzgjedhur, por mos e mbingarkoni. Shikoni, "Tabela e programeve dhe konsumit".
- Ndiqni udhëzimet në paketimin e detergjentit lidhur me temperaturën.
- Lajini rrobat pak të ndotura në temperatura të ulëta.
- Përdorni programe më të shpejta për sasira të vogla rrobash pak të ndotura.
- Mos përdorni paralarje dhe temperatura të larta për rroba që nuk janë shumë të ndotura apo me shumë njolla.
- Nëse keni ndërmend t'i thani rrobat në makinë tharëse, zgjidhni shpejtësinë më të lartë të centrifugës së rekomanduar gjatë procesit të larjes.
- Mos përdorni më tepër detergjent nga sa rekomandohet në paketimin e detergjentit.

4.2.4 Futja e rrobave për larje

1. Hapni derën e ngarkimit.
2. Vendosini rrobat në pajisje në mënyrë të lirshme.
3 Shtyjeni derën e ngarkimit për ta mbyllur derisa të dëgjoni tingullin e kyçjes. Sigurohuni që të mos kenë mbetur rroba të kapura te dera. Dera e ngarkimit kyçet ndërsa një program është në punë. Kyçi i derës do të hapet menjëherë pasi të ketë mbaruar programi i larjes. Pastaj mund të hapni derën. Nëse dera nuk hapet, përdorni zgjidhjet e dhëna për gabimin "Dera e ngarkimit nuk mund të hapet." në pjesën Zgjidhja e problemeve.


4.2.5 Kapaciteti i duhur

Kapaciteti maksimal i ngarkesës varet nga lloji i rrobave, shkalla e ndotjes dhe programi i dëshiruar i larjes. Produkti e rregullon automatikisht sasinë e ujit sipas peshës së rrobave të futura në të.

PARALAJMËRIM: Përmbajuni informacioneve në pjesën "Tabela e programeve dhe konsumit". Në rast të tejmbushjes, rendimenti larës i produktit do të bjerë. Për më tepër, mund të ketë probleme me zhurmën dhe dridhjet.

4.2.6 Përdorimi i detergjentit dhe zbutësit

Kur përdorni detergjent, zbutës, niseshte, ngjyrues rrobash, zbardhues dhe agjentë zhgëlqerëzues; lexoni udhëzimet e prodhuesit të shkruara mbi paketim dhe ndiqni dozat e përcaktuara. Përdorni gotën e masës nëse ka.



Sirtari i detergjentit përbëhet nga tre ndarje:
– (1) për paralarjen
– (2) për larjen kryesore
– (3) për zbutësin
– (❀) në vazhdim, për më tepër ka një pjesë sifoni në ndarësen e zbutësit.

Detergjenti, zbutësi dhe agjentët e tjerë të pastrimit

- Shtoni detergjent dhe zbutës përpara nisjes së programit të larjes.
- Ndërkohë që cikli i larjes është në proces, mos e lini sirtarin e detergjentit të hapur!
- Kur përdorni një program pa paralarje, mos vendosni detergjent në ndarësen e paralarjes (ndarësja nr. "1").
- Në një program me paralarje, mos vendosni detergjent të lëngshëm në ndarësen e paralarjes (ndarësja nr. "1").
- Mos përzgjidhni një program me paralarje nëse do të përdorni një qeskë detergjenti ose tabletë të tretshme. Vendoseni qeskën e detergjentit ose tabletën e tretshme direkt midis rrobave në pajisje.
- Nëse po përdorni detergjent të lëngshëm, mos harroni ta hidhni detergjentin e lëngshëm në ndarjen e larjes kryesore (ndarja nr. "2").

Zgjedhja e llojit të detergjentit

LLloji i detergjentit që do të përdoret varet nga programi i zgjedhur, lloji dhe ngjyra e tekstilit.

- Përdorni detergjente të ndryshme për rrobat me ngjyra dhe të bardha.
- Lajini rrobat delikate vetëm me detergjente të veçanta (detergjent të lëngshëm, shampo për rroba të leshta, etj.) që përdoren posaçërisht për rroba delikate.
- Kur lani rroba me ngjyra të errëta apo jorganë, rekomandohet që të përdoret detergjent i lëngshëm.
- Lajini rrobat e leshta me detergjente të veçanta të prodhuar posaçërisht për të leshtat.
- Ju lutemi lexoni sërish përshkrimet e programës për programin e sugjeruar për tekstile të ndryshme.
- Të gjitha rekomandimet për detergjentët janë valide për gamën e temperaturës që mund të zgjedhet të programës.

PARALAJMËRIM: Përdorni vetëm detergjente të prodhuar në mënyrë të posaçme për makina larëse.

PARALAJMËRIM: Mos përdorni pluhur sapuni.

Rregullimi i sasisë së detergjentit

Sasia e detergjentit larës që duhet të përdoret varet nga sasia e rrobave, niveli i ndotjes dhe fortësia e ujit.

- Mos përdorni sasi që i tejkalojnë dozat e rekomanduara në paketimin e detergjentit për të shmangur problemet e shkumës së tepërt, shpëlarjes jo të mirë, kursimeve financiare dhe në fund, mbrojtjes së mjedisit.
- Përdorni më pak detergjent për sasi të vogla të rrobave ose për rroba jo shumë të ndotura.

Përdorimi i zbutësve

Hidheni zbutësin në ndarësen e zbutësit të sirtarit të detergjentit.


- Mos e kaloni shenjën e nivelit (>max<) në ndarjen e zbutësit.
- Nëse zbutësi e ka humbur fluiditetin, hollojeni atë me ujë para se ta hidhni në ndarjen e detergjentit.

PARALAJMËRIM: Mos përdorni detergjentë të lëngshëm ose produkte të tjera pastrimi për të zbutur rrobat, përveç zbutësve të rrobave të prodhuar posaçërisht për makina larëse.

Përdorimi i detergjentëve të lëngshëm


Nëse produkti ka një gotë për detergjent të lëngshëm.

- Hidheni mbajtësin e detergjentit të lëngshëm në ndarjen nr. “2”.
- Nëse detergjenti i lëngshëm e ka humbur fluiditetin, hollojeni atë me ujë para se ta vendosni në mbajtësin e detergjentit.



Nëse produkti është i pajisur me një pjesë detergjenti të lëngshëm:

- Kur doni të përdorni detergjent të lëngshëm, tërhiqeni aparatin drejt vetes. Pjesa që bie poshtë do të shërbejë si barrierë për detergjentin e lëngshëm. Nëse është e nevojshme, pastrojeni aparatin me ujë kur është në vend ose duke e hequr. Nëse do të përdorni detergjent pluhur, aparati duhet të sigurohet në pozicionin e sipërm.



Nëse produkti nuk ka një gotë për detergjent të lëngshëm:

- Mos përdorni detergjentë të lëngshëm për paralarjen në një program me paralarje.
- Detergjenti i lëngshëm i njollos rrobat kur përdoret me funksionin "Koha e mbarimit" për ta filluar programin në një moment të mëvonshëm. Nëse do të përdorni funksionin End Time (Koha e mbarimit), mos përdorni detergjent të lëngshëm.

Përdorimi i detergjentit xhel dhe tabletave

- Nëse trashësia e detergjentit xhel është e lëngshme dhe pajisja juaj nuk ka një enë të veçantë për detergjentin e lëngshëm, hidheni detergjentin xhel në ndarjen kryesore të detergjentit larës gjatë marrjes së parë të ujit. Nëse pajisja juaj ka një enë për detergjent të lëngshëm, hidheni detergjentin në këtë enë para se të filloni programin.
- Nëse trashësia e detergjentit xhel nuk është e lëngshme ose është në formën e kapsulës së lëngshme, futeni direkt në kazan para larjes.
- Hidhini tabletat në ndarjen kryesore të larjes (ndarja nr. "2") ose direkt në kazan para larjes.

Përdorimi i niseshtesë së rrobave

- Shtoni niseshte të lëngshme, niseshte pluhur ose ngjyrues në ndarjen e zbutësit.
- Mos përdorni zbutës dhe niseshte rrobash së bashku në një cikël larjeje.
- Fshijeni pjesën e brendshme të pajisjes me leckë të njomë dhe të pastër pasi të keni përdorur niseshte.

Përdorimi i zhgëlqerëzuesit


- Kur nevojitet, përdorni zhgëlqerëzues të prodhuar posaçërisht për makinat larëse.

Përdorimi i zbardhuesve

- Zgjidhni një program me paralarje dhe shtoni zbardhues në fillim të paralarjes. Mos vendosni detergjent në ndarësen e paralarjes. Si aplikim alternativ, zgjidhni një program me shpëlarje ekstra dhe shtoni zbardhuesin ndërkohë që produkti po merr ujë nga ndarja e detergjentit gjatë shpëlarjes së parë.
- Mos përdorni zbardhues dhe detergjent duke i përzier.
- Përdorni vetëm një sasi të vogël (rreth 50 ml) zbardhuesi dhe shpëlajini rrobat mirë pasi kjo mund të shkaktojë acarim të lëkurës.
- Mos e hidhni zbardhuesin mbi rroba.
- Mos e përdorni me rrobat me ngjyra.
- Kur përdorni zbardhues me bazë oksigjeni, zgjidhni një program që i lan rrobat në temperaturë të ulët.
- Zbardhuesit me bazë oksigjeni duhet të përdoren së bashku me detergjentin. Sidoqoftë, nëse trashësia e tij nuk është e njëjtë me atë të detergjentit, hidhni detergjentin në fillim në ndarjen nr. "2" në sirtarin e detergjentit dhe prisni derisa detergjenti të rrjedhë ndërkohë që pajisja merr ujë. Ndërsa pajisja vazhdon të marrë ujë, shtoni zbardhuesin në të njëjtën ndarje.


4.2.7 Këshilla për larje efikase

		Rrobat			
		Ngjyra të lehta dhe të bardha	**Me ngjyra**	**Ngjyra të zeza/ të errëta**	**Delikate/ Të leshta/Të mëndafshta**
		(Shkalla e temperaturës së rekomanduar në bazë të nivelit të ndotjes: 40-90°C)	(Intervali i rekomanduar i temperaturës në bazë të nivelit të njollave: ftohtë -40°C)	(Intervali i rekomanduar i temperaturës në bazë të nivelit të njollave: ftohtë -40°C)	(Intervali i rekomanduar i temperaturës në bazë të nivelit të njollave: ftohtë -30°C)
Niveli i ndotjes	**Shumë të ndotura** (njolla të vështira të tilla si bari, kafeja, frutat dhe gjaku.)	Mund të jetë e nevojshme që njollat të para-trajtohen ose të kryhet paralarja. Detergjentët pluhur dhe të lëngshëm të rekomanduar për rrobat e bardha mund të përdoren në dozat e rekomanduara për rrobat shumë të ndotura. Rekomandohet që të përdoren detergjentë pluhur për të pastruar njollat e baltës dhe të dheut dhe njollat që janë të ndjeshme ndaj zbardhuesve.	Detergjentët pluhur dhe të lëngshëm të rekomanduar për rrobat me ngjyra mund të përdoren në dozat e rekomanduara për rrobat shumë të ndotura. Rekomandohet që të përdoren detergjentë pluhur për të pastruar njollat e baltës dhe të dheut dhe njollat që janë të ndjeshme ndaj zbardhuesve. Detergjentët që nuk përmbajnë zbardhues nuk duhet të përdoren.	Detergjentët e lëngshëm të përshtatshëm për rrobat me ngjyra dhe të errëta mund të përdoren në dozat e rekomanduara për rrobat shumë të ndotura.	Parapëlqeni detergjentët e lëngshëm të prodhuar për rrobat delikate. Rrobat e leshta dhe të mëndafshta duhet të lahen me detergjentë të veçantë për të leshtat.
	Me ndotje normale (Për shembull, njollat të shkaktuara nga trupi në jaka dhe mëngë)	Detergjentët pluhur dhe të lëngshëm të rekomanduar për rrobat e bardha mund të përdoren në dozat e rekomanduara për rrobat me ndotje normale.	Detergjentët pluhur dhe të lëngshëm të rekomanduar për rrobat me ngjyra mund të përdoren në dozat e rekomanduara për rrobat me ndotje normale. Detergjentët që nuk përmbajnë zbardhues nuk duhet të përdoren.	Detergjentët e lëngshëm të përshtatshëm për rrobat me ngjyra dhe të errëta mund të përdoren në dozat e rekomanduara për rrobat me ndotje normale.	Parapëlqeni detergjentët e lëngshëm të prodhuar për rrobat delikate. Rrobat e leshta dhe të mëndafshta duhet të lahen me detergjentë të veçantë për të leshtat.
	Pak të ndotura (Nuk ka njolla të dukshme.)	Detergjentët pluhur dhe të lëngshëm të rekomanduar për rrobat e bardha mund të përdoren në dozat e rekomanduara për rrobat pak të ndotura.	Detergjentët e lëngshëm të përshtatshëm për rrobat me ngjyra mund të përdoren në dozat e rekomanduara për rrobat pak të ndotura. Detergjentët që nuk përmbajnë zbardhues nuk duhet të përdoren.	Detergjentët e lëngshëm të përshtatshëm për rrobat me ngjyra dhe të errëta mund të përdoren në dozat e rekomanduara për rrobat pak të ndotura.	Parapëlqeni detergjentët e lëngshëm të prodhuar për rrobat delikate. Rrobat e leshta dhe të mëndafshta duhet të lahen me detergjentë të veçantë për të leshtat.




4.3 Përdorimi i produktit

4.3.1 Paneli i kontrollit



1 - Çelësi i zgjedhjes të programit
2 - Dritat e nivelit të temperaturës
3 - Dritat e nivelit të centrifugimit
4 - Ekrani
5 - Butoni Nisje / Pushim
6 - Butoni i telekomandës.
7 - Butoni i cilësimit të kohës së mbarimit
8 - Butoni i funksionit ndihmës 3
9 - Butoni i funksionit ndihmës 2
10 - Butoni i funksionit ndihmës 1
11 - Butoni i rregullimit të shpejtësisë së centrifugimit
12 - Butoni i rregullimit të temperaturës

4.3.2 Simbolet e ekranit



a- Treguesi i temperaturës
b- Treguesi i shpejtësisë së centrifugimit
c- Informacione të kohëzgjatjes
d- Simboli kyçi i derës është aktivizuar
e- Treguesi i ndjekjes së programit
f- Treguesi Nuk ka ujë
g- Treguesi Futni rrobat
h- Treguesi i Lidhjes Bluetooth
i- Treguesi i telekomandës
j- Simboli nisja e vonuar e aktivizuar
k- Treguesit e funksionit ndihmës 3
l- Simboli kyçi i fëmijës është aktivizuar
m- Treguesit e funksionit ndihmës 2
n- Treguesit e funksionit ndihmës 1
o- Treguesi Pa centrifugim
p- Treguesi Mbaj në shpëlarje
r- Treguesi Ujë i ftohtë

Mjetet vizuale për përshkrimin e lavatriçes në këtë pjesë janë skematike dhe mund të mos përputhen saktësisht me veçoritë e makinës tuaj.

4.3.3 Tabela e programit dhe konsumit

SQ						funksionit plotësues					
Programi		Ngarkesa Maksimale (kg)	Konsumi i Ujit (l)	Konsumi i Energjisë (kilovat-orë)	Shpejtësia maks.	E shpejtë+	Paralarje	Shpëlarje Ekstra	Avull	Anti-rrudhë+	Shtrirja e temperature range °C
Cottons	90	6	75	2.00	1000	•	•	•	•	•	Cold - 90
	60	6	75	1.60	1000	•	•	•	•	•	Cold - 90
	40	6	73	0.95	1000	•	•	•	•	•	Cold - 90
Eco 40-60	40 ***	6	45.0	0.950	1000						40 - 60
	40 ***	3	31.0	0.450	1000						40 - 60
	40 ***	3	24.0	0.310	1000						40 - 60
	60	6	45.0	0.960	1000						40 - 60
	60	3	31.0	0.460	1000						40 - 60
Synthetics	60	3	60	1.20	1000	•	•	•	•	•	Cold - 60
	40	3	58	0.85	1000	•	•	•	•	•	Cold - 60
Express / Super Xpress	90	6	65	1.95	1000	•		•	•	•	Cold - 90
	60	6	65	1.00	1000	•		•	•	•	Cold - 90
	30	6	63	0.15	1000	•		•	•	•	Cold - 90
Express / Super Xpress + Fast+	30	2	37	0.10	1000	•		•	•	•	Cold - 90
Wool/HandWash	40	1.5	50	0.50	1000			•			Cold - 40
Gentle Care	40	3	45	0.70	800			•			Cold - 40
Dark Care / Jeans	40	3	60	0.80	1000	•	•	*	•	•	Cold - 40
Outdoor / Sport	40	3	45	0.50	1000		•				Cold - 40
Stain Expert	60	3	75	1.55	1000	•	•				30-60
Hygiene+	90	6	105	2.10	1000			*	*		20-90
Down Wear	60	1.5	60	1.00	1000			•	•		Cold - 60
Shirts	60	3	50	0.75	800	•	•	•	•	•	Cold - 60
Pastrim kazani+	90	-	65	2.10	600				*		90
Downloaded Program (Programi i shkarkuar)*****											
Të përziera	40	3	62	0.75	800	•	•		•	•	Cold - 40
Perdet	40	2	55	0.65	800		•	*			Cold - 40
Të brendshme grash	30	1	55	0.30	600			*			Cold - 30
Lodrat e buta	40	1.5	53	0.50	600			*			Cold - 40
Peshqir	60	1.5	75	1.20	1000			*	•		Cold - 60

• : Mund të zgjidhet.
* : Zgjidhet automatikisht, nuk mund të anulohet.

*** : Nëse shpejtësia maksimale e centrifugimit të lavatriçes është më poshtë se kjo vlerë, mund të përzgjidhni vetëm deri në shpejtësinë maksimale të centrifugimit.

***** : Këto programe mund të përdoren me aplikacionin HomeWhiz.

\- : Shikoni përshkrimin e programit për ngarkesën maksimale.

** "Pambuk eko 40 °C dhe Pambuk eko 60 °C janë programe standarde." Këto programe njihen si "program standard pambuku 40°C" dhe "program standard pambuku 60°C" dhe tregohen në panel me simbolet 40° 60° .

Funksionet ndihmëse në tabelë mund të variojnë sipas modelit të lavatriçes tuaj.
Konsumi i ujit dhe i energjisë mund të variojë si pasojë e ndryshimeve të presionit të ujit, fortësisë së ujit dhe temperaturës, temperaturës së mjedisit, llojit dhe sasisë së rrobave, përzgjedhjes së funksioneve ndihmëse dhe shpejtësisë së centrifugimit, si dhe ndryshimeve në tensionin elektrik.
Mund të shikoni kohëzgjatjen e larjes në ekranin e lavatriçes ndërsa zgjidhni një program. Në varësi të sasisë së rrobave që keni futur në lavatriçe, mund të ketë një ndryshim prej 1-1,5 orësh midis kohëzgjatjes së treguar në ekran dhe kohëzgjatjes reale të ciklit të larjes. Kohëzgjatja do të përditësohet shpejt sapo të fillojë larja.
"Strukturat e zgjedhjes për funksionet ndihmëse mund të ndryshohen nga kompania e prodhimit. Modele të reja zgjedhjeje mund të shtohen ose të hiqen." "Shpejtësia e centrifugimit të lavatriçes tuaj mund të ndryshojë në varësi të programit; kjo shpejtësi centrifuge nuk mund ta tejkalojë shpejtësinë maksimale të centrifugimi të lavatriçes suaj."


Vlera e konsumit (SQ)								
	Zgjedhja e temperaturës (°C)	Shpejtësia e rrotullimit (rpm)	Kapaciteti (kg)	Kohëzgjatja e programës (hh:mm)	Konsumi i energjisë (kWh/cikël)	Konsumi i ujit (L/cikël)	Temperatura e larjes (°C)	Përmbajtja e lagështisë së mbetur (%)
Eco 40-60	40	1000	6	3:17	0.950	45.0	45	61
	40	1000	3	2:35	0.450	31.0	30	61
	40	1000	1.5	2:35	0.310	24.0	25	66
Cottons	20	1000	6	03:25	0.650	73.0	20	62
Cottons	60	1000	6	03:25	1.600	75.0	60	62
Synthetics	40	1000	3	02:15	0.850	58.0	40	45
Express / Super Xpress	30	1000	6	00:28	0.150	63.0	23	62

4.3.4 Përzgjedhja e programit

1 Përcaktoni programin e përshtatshëm për llojin, sasinë dhe nivelin e ndotjes së rrobave në përputhje me tabelën "Tabela e programeve dhe konsumit".

Programet janë të kufizuar me shpejtësinë më të madhe të centrifugimit të përshtatshme për ato lloj të veçantë të pëlhurës.
Kur përzgjidhni një program, merrni gjithmonë në konsideratë llojin e materialit, ngjyrën, shkallën e ndotjes dhe temperaturën e lejuar të ujit.
Zgjidhni gjithmonë temperaturën më të ulët të përshtatshme. Temperatura më e lartë do të thotë më shumë konsum energjie.

2 Zgjidhni programin e dëshiruar me çelësin **Zgjedhja e programit** .



4.3.5 Programet

• Cottons (Pambuk)

Mund të lani rrobat tuaja rezistente prej pambuku (çarçafë, mbulesa, peshqirë, rroba dushi, të brendshme etj.) në këtë program. Kur shtypet butoni i funksionit të larjes së shpejtë, kohëzgjatja e programit bëhet dukshëm më e shkurtër por rendimenti larës efikas garantohet me lëvizje larjeje intensive. Nëse nuk zgjidhet funksioni i larjes së shpejtë, garantohet një rendiment superior i larjes dhe i shpëlarjes për rrobat tuaja shumë të ndotura.

• Synthetics (Sintetike)
Mund t'i lani rrobat tuaja (si këmishët, bluzat, copat me përzierje sintetike/pambuku, etj.) në këtë program. Kohëzgjatja e programit bëhet dukshëm më e shkurtër dhe garantohet rendiment i lartë. Nëse nuk zgjidhet funksioni i larjes së shpejtë, garantohet një rendiment superior i larjes dhe i shpëlarjes për rrobat tuaja shumë të ndotura.

• Woollens / Hand Wash (Të leshtat / Larje me dorë)
Përdoreni për të larë rrobat e leshta/delikate. Zgjidhni temperaturën e duhur duke iu përmbajtur etiketave të rrobave tuaja. Rrobat tuaja do të lahen me një veprim shumë të butë për të mos i dëmtuar rrobat.

• Eco 40-60
Programi eco 40-60 është në gjendje të pastrojë bashkë në të njëjtin cikël, rrobat e pambukta të ndotura normalisht të deklaruara se mund të lahen në 40 °C ose 60 °C, dhe ky program përdoret për të vlerësuar pajtueshmërinë me legjislacionin e BE-së për dizajnimet ekologjike. Megjithëse lan më gjatë se të gjitha programet e tjera, ky garanton kursime të larta të energjisë dhe ujit. Temperatura e tanishme e ujit mund të jetë e ndryshme nga temperatura e treguar e larjes. Kur e ngarkoni pajisjen me më pak rroba (p.sh. ½ e kapacitetit ose më pak), periudhat në fazat e programit mund të bëhen automatikisht më të shkurtra. Në këtë rast, konsumi i energjisë dhe i ujit do të ulet.

• Hygiene+/Anti Allergy (Antialergjik)
Përdoreni këtë program për rrobat tuaja (rrobat e foshnjës, çarçafët, këllëfët, të brendshmet etj., produkte pambuku) që kërkojnë larje antialergjike dhe higjienike në temperaturë të lartë me cikël intensiv dhe të gjatë larjeje. Niveli i lartë i higjienës garantohet falë kohëzgjatjes së madhe të nxehjes dhe shpëlarjes ekstra.

• Programi është testuar nga instituti "VDE" me opsion temperature 20°C të zgjedhur dhe është certifikuar për sa i përket efikasitetit në eliminimin e baktereve dhe mykut.

• Programi është testuar nga "The British Allergy Foundation" (Allergy UK) me opsionin e temperaturës 60°C të zgjedhur dhe është certifikuar për sa i përket efikasitetit në eliminimin e alergjeneve përveç baktereve dhe mykut.

BRITISH ALLERGY FOUNDATION · ALLERGY UK SEAL OF APPROVAL	Allergy UK është markë e British Allergy Association. Vula e Aprovimit krijohet për të udhëzuar njerëzit që kërkojnë rekomandim për një produkt se produkti përkatës ndalon/ pakëson/eliminon alergjenët ose pakëson ndjeshëm sasinë e alergjenëve në ambientet ku ndodhen pacientë me alergji. Synon të japë sigurinë se produktet janë testuar shkencërisht ose ekzaminuar në mënyrë të tillë për të dhënë rezultate që mund të maten.

• Down Wear(Veshje)
Përdoreni këtë program për të larë palltot, jelekët, xhaketat etj. që përmbajnë pupla me etiketë "për larje në makinë larëse" në to. Falë profileve të veçanta të centrifugimit, sigurohet që uji të arrijë në boshllëqet e ajrit mes puplave.

• Spin+Drain (Centrifugim+Shkarkim)
Mund ta përdorni këtë funksion për të hequr ujin në rroba ose për ta shkarkuar ujin nga lavatriçja.

• Rinse (Shpëlarje)
Përdoreni kur doni të shpëlani ose zbardhni veç.

• Perdet
Mund ta përdorni këtë program për të larë tylet dhe perdet. Meqë struktura e tyre në formë rrjete shkakton shumë shkumë, lajini vellot/tylet duke vendosur një sasi të vogël detergjenti në ndarësen kryesore të larjes. Falë profilit të veçantë të centrifugimit të programit, tylet dhe perdet rrudhosen më pak. Mos futni perde mbi kapacitetin e caktuar me qëllim që të mos i dëmtoni.

i	Rekomandohet që të përdorni detergjentë të veçantë të prodhuar për perdet në ndarësin e detergjentit pluhur në këtë program.

• Shirts (Këmishët)
Ky program përdoret për të larë këmisha prej pambuku, copa sintetike dhe me përzierje sintetike së bashku. Pakëson rrudhat. Kur zgjidhet funksioni i larjes së shpejtë, ekzekutohet algoritmi i para-trajtimit.

• Aplikojeni lëndën kimike të para-trajtimit direkt mbi teshat tuaja ose shtojeni së bashku me detergjentin kur lavatriçja fillon të marrë ujë nga ndarja e detergjentit të pluhurit. Kështu mund të keni të njëjtin rendiment si me larjen normale në periudhë shumë më të shkurtër. Jetëgjatësia e përdorimit të këmishëve tuaja rritet.

• Daily Express / Xpress Super Short (Larja ditore e shpejtë / Super e shkurtër)
Përdoreni këtë program për të larë rrobat tuaja prej pambuku të ndotura pak ose pa njolla në një kohë të shkurtër. Kohëzgjatja e programit mund të reduktohet deri në 14 minuta kur zgjidhet funksioni i larjes së shpejtë. Kur zgjidhet funksioni i larjes së shpejtë, mund të lahen deri në maksimumi 2 (dy) kg rroba.
• Dark Care / Jeans (Të errëtat / Xhinseve)
Përdoreni këtë program për të mbrojtur ngjyrat e rrobave tuaja me ngjyrë të errët ose xhinseve. Bën larje me rendiment të lartë me lëvizje të veçantë të kazanit edhe nëse temperatura është e ulët. Rekomandohet të përdorni detergjent të lëngshëm ose shampo për të leshtat për rrobat me ngjyra të errëta. Mos i lani rrobat delikate që përmbajnë lesh ose të tjera.
• Të përziera
Përdoreni për të larë rrobat prej pambuku dhe sintetike pa i ndarë ato.
• Gentle Care (Delikate)
Mund të lani rrobat tuaja delikate të tilla si trikotazhet ose çorapet me përzierje pambuku/sintetike në këtë program. Lan me veprim larjeje më delikat. Lani rrobat të cilave doni t'u mbroni ngjyrat qoftë në 20 gradë ose duke zgjedhur opsionin e larjes së ftohtë.
• Të brendshme grash
Mund ta përdorni këtë program për të larë rrobat delikate që janë të përshtatshme për larje me dorë dhe të brendshmet delikate të grave. Sasitë e vogla të rrobave duhet të lahen në rrjetë larjeje. Çengelët, kopsat dhe zinxhirët duhet të mbyllen.
• Outdoor / Sports (Veshjet sportive)
Mund ta përdorni këtë program për të larë rrobat tuaja sportive dhe ato për jashtë që përmbajnë përzierje pambuku/sintetike dhe mbulesa kundër ujit si gore-tex, etj. Sigurohet që rrobat tuaja të lahen me delikatesë falë lëvizjeve rrotulluese të veçanta.
• Stain Expert (Ekspert njollash)
Lavatriçja ka një program të veçantë njollash i cili bën të mundur heqjen e llojeve të ndryshme të njollave në mënyrën më të efektshme. Përdoreni këtë program vetëm për rrobat e pambukta me ngjyra. Mos i lani rrobat delikate dhe të pigmentuara dhe rrobat e tjera në këtë program. Para se të lani, duhet të kontrollohen etiketat e rrobave (rekomandohet për këmishët prej pambuku, pantallonat, të shkurtrat, bluzat t-shirt, rrobat e bebeve, pizhamet, përparëset, mbulesat e tavolinave, mbulesat e krevatit, çarçafët, këllëfët e jastëkut, peshqirët e dushit ose plazhit, peshqirët, çorapet, të brendshmet prej pambuku që janë të përshtatshme për t'u larë në temperaturë të lartë dhe për kohë të gjatë). Në programin automatik të njollave, mund të lani 24 lloje njollash të ndara në dy grupe të ndryshme sipas zgjedhjes së funksionit të shpejtë. Mund t'i shikoni grupet e njollave në bazë të zgjedhjes së funksionit të shpejtë.
Mund t'i gjeni grupet e njollave në bazë të funksionit të shpejtë më poshtë:

Kur zgjidhet funksioni i shpejtë:		
Gjak	Çaj	Verë e kuqe
Çokollatë	Kafe	Kerri
Puding	Lëng frutash	Reçel
Vezë	Keçap	Qymyr

Kur nuk zgjidhet funksioni i shpejtë:		
Gjalpë	Djersë	Salcë sallate
Bar	Ndotje e qafës	Makijazh
Baltë	Ushqim	Vaj makinerie
Coca Cola	Majonezë	Ushqim bebesh

• Zgjidhni programin e njollave.
• Zgjidhni njollat që doni të lani duke i vendosur në grupet më sipër dhe duke zgjedhur grupin përkatës me butonin e funksionit të shpejtë ndihmës.
• Lexoni etiketën e copave me kujdes dhe sigurohuni që të zgjidhen temperatura dhe shpejtësia e duhur e centrifugimit.

• Downloaded Program (Programi i shkarkuar)

Ky është një program i veçantë që ju lejon të shkarkoni programe të ndryshme kur të doni. Në fillim, ekziston një program që mund të shihni me aplikacionin HomeWhiz si parazgjedhje. Megjithatë, mund të përdorni aplikacionin HomeWhiz për të zgjedhur një program nga seti i programeve të paracaktuara dhe pastaj ta ndryshoni dhe ta përdorni atë.

Nëse dëshironi të përdorni funksionin HomeWhiz dhe funksionin e telekomandës, ju duhet të zgjidhni Programin e shkarkuar. Informacione të hollësishme mund të gjenden në 4.3.15 Funksioni HomeWhiz dhe funksioni i telekomandës.

• Lodrat e buta

Lodrat e buta duhet të lahen në një program delikat për shkak të pëlhurave të tyre delikate, fibrave dhe aksesorëve që ato përmbajnë. Falë lëvizjeve delikate të larjes dhe profilit të centrifugimit, programi i lodrave të buta i mbron lodrat gjatë larjes. Rekomandohet që të përdorni detergjent të lëngshëm.


Lodrat e brishta me sipërfaqe të forta nuk duhet të lahen në asnjë mënyrë.

Lodrat nuk duhet të lahen së bashku me teshat pasi ato mund të dëmtojnë rrobat.

• Peshqir

Përdoreni këtë program për të larë rrobat e pambukta të qëndrueshme siç janë peshqirët. Futini peshqirët në lavatriçe duke bërë kujdes për t'i vendosur në një mënyrë që të mos bien në kontakt me gomën e ajrit ose xhamin.

4.3.6 Zgjedhja e temperaturës




Kurdoherë që zgjidhet një program i ri, temperatura e rekomanduar për programin shfaqet në treguesin e temperaturës. Është e mundur që vlera e rekomanduar e temperaturës të mos jetë temperatura maksimale që mund të zgjidhet për programin aktual. Shtypni butonin **Rregullimi i temperaturës** për të ndryshuar temperaturën. Temperatura bie ngadalë.

Nuk mund të bëhen ndryshime në programet ku nuk lejohet rregullimi i temperaturës.

Mund ta ndryshoni temperaturën pasi të fillojë larja. Ky ndryshim mund të bëhet nëse hapat e larjes e lejojnë. Nuk mund të bëhen ndryshime nëse hapat nuk e lejojnë.

Nëse shkoni në opsionin e larjes së ftohtë dhe shtypni përsëri butonin Rregullimi i temperaturës, temperatura maksimale e rekomanduar për programin e zgjedhur shfaqet në ekran. Shtypni përsëri butonin Rregullimi i temperaturës për të ulur temperaturën.

4.3.7 Përzgjedhja e shpejtësisë së centrifugimit



Kur përzgjidhet një program i ri, shpejtësia e rrotullimit që rekomandohet për programin e përzgjedhur shfaqet në treguesin **Shpejtësia e centrifugimit** .

	Është e mundur që vlera e rekomanduar e shpejtësisë së centrifugimit të mos jetë shpejtësia maksimale e centrifugimit që mund të zgjidhet për programin aktual.

Shtypni butonin **Rregullim i shpejtësisë së centrifugimit** për të ndryshuar shpejtësinë e centrifugimit. Shpejtësia e centrifugimit bie ngadalë.
Pastaj, në varësi të modelit të produktit, opsionet "Mbaj në shpëlarje" dhe "Pa rrotullim" shfaqen në ekran.
Nëse nuk do t'i hiqni rrobat menjëherë pasi të përfundojë programi, mund të përdorni funksionin **Mbaj në shpëlarje** për të mos i lejuar të rrudhosen kur nuk ka ujë në lavatriçe.
Funksioni i mban rrobat në shpëlarjen finale me ujë.
Nëse doni të shtrydhni rrobat pas funksionit Mbaj në shpëlarje:
- Rregulloni **Shpejtësinë e centrifugimit**.
- Shtypni butonin **Fillo/Pusho/Anulo**. Programi do të vazhdojë. Lavatriçja kullon ujin dhe centrifugon rrobat.
Nëse doni t'i kulloni rrobat në fund të programit pa bërë centrifugim, përdorni funksionin **Pa Centrifugim**.


	Nuk mund të bëhen ndryshime në programet ku nuk lejohet rregullimi i shpejtësisë së centrifugimit.

Mund ta ndryshoni shpejtësinë e centrifugimit pasi të fillojë larja dhe nëse hapat e larjes e lejojnë. Nuk mund të bëhen ndryshime nëse hapat nuk e lejojnë.

Mbaj në shpëlarje

Nëse nuk do t'i zbrazni rrobat menjëherë pasi programi të përfundojë, mund të përdorni funksionin e mbajtjes në shpëlarje për t'i mbajtur rrobat tuaja në ujin e shpëlarjes së fundit me qëllim që të parandalojë që ato të zhubrosen kur në makineri nuk ka ujë. Shtypni butonin Fillo/Pusho pas këtij procesi nëse doni të thani ujin pa i shtrydhur rrobat tuaja. Programi do të rifillojë dhe do të përfundojë pas shkarkimit të ujit.
Nëse doni të shtrydhni rrobat që gjenden në ujë, rregulloni Shpejtësinë e centrifugimit dhe shtypni butonin Fillo/Pusho.
Programi do të vazhdojë. Uji kullohet, rrobat shtrydhen dhe programi përfundon.

4.3.8 Përzgjedhja e funksionit ndihmës



Përzgjidhni funksionet e dëshiruara ndihmëse para se të nisni programin. Kurdoherë që zgjidhet një program, ikonat e simbolit të funksionit ndihmës që mund të zgjidhen së bashku me të ndriçojnë.

	Kur shtypet një buton i funksionit ndihmës që nuk mund të zgjidhet me programin aktual, lavatriçja do të bëjë një tingull paralajmërues.

Gjithashtu kornizat e funksionit ndihmës të përzgjedhur për programin aktual pasi ka filluar larja mbeten të ndriçuara.

	Disa funksione nuk mund të përzgjidhen së bashku. Nëse një funksion i dytë ndihmës që bie në konflikt me të parin përzgjidhet para vënies në punë të pajisjes, funksioni i përzgjedhur i pari do të anulohet dhe funksioni i dytë ndihmës do të mbetet aktiv. Për shembull, nëse doni të zgjidhni Larjen e shpejtë pasi keni zgjedhur Ujë shtesë, Uji shtesë mund të anulohet dhe Larja e shpejtë do të mbetet aktive.
	Nuk mund të përzgjidhet një funksion ndihmës që nuk ka përputhje me programin. (Shikoni "Tabela e programeve dhe konsumit".)
	Disa programe kanë funksione ndihmëse që mund të përdoren njëkohësisht. Ato funksione nuk duhet të anulohen. Korniza e funksionit ndihmës nuk do të ndriçohet, vetëm pjesa e brendshme do të ndriçohet.

4.3.8.1 Funksionet ndihmëse

- **Paralarje**

Paralarja ia vlen të përdoret vetëm për rroba shumë të ndotura. Mospërdorimi i Paralarjes do të kursejë energji, ujë, detergjent dhe kohë.

• E shpejtë+

Pas zgjedhjes së një programi, mund të shtypni butonin e cilësimit të larjes së shpejtë për të shkurtuar kohëzgjatjen e programit. Për disa programe, kohëzgjatja mund të shkurtohet me mbi 50%. Përveç kësaj, rendimenti i larjes është i mirë falë algoritmit të ndryshuar.

Megjithëse ndryshon në secilin program, kur shtypni butonin Larja e shpejtë një herë, kohëzgjatja e programit zvogëlohet në një nivel të caktuar dhe kur shtypni të njëjtin buton për herë të dytë, ajo zbret në nivelin minimal. Për një rendiment më të mirë të larjes, mos përdorni butonin e cilësimit të larjes së shpejtë kur lani rroba shumë të ndotura.

Shkurtoni kohëzgjatjen e programit duke përdorur butonin e larjes së shpejtë për rroba mesatarisht dhe pak të ndotura.

• Avull

Përdoreni këtë program për të pakësuar rrudhat dhe për të shkurtuar kohën e hekurosjes të një sasie të vogël rrobash pambuku, sintetike ose të përziera pa njolla.

• Telekomanda

Mund ta përdorni këtë çelës funksioni ndihmës për të lidhur pajisjen tuaj me pajisje inteligjente. Informacione të hollësishme mund të gjenden në 4.3.15 Funksioni HomeWhiz dhe funksioni i telekomandës.

• Programi i përshtatur

Ky funksion ndihmës mund të përdoret vetëm për programet e pambukut dhe sintetikeve së bashku me aplikacionin HomeWhiz. Kur ky funksion ndihmës aktivizohet, mund të shtoni deri në 4 hapa ndihmës të shpëlarjes në program. Mund të zgjidhni dhe përdorni disa funksione ndihmëse edhe pse ato nuk gjenden në pajisjen tuaj. Mund të rrisni dhe ulni kohën e programeve të pambukut dhe sintetikeve brenda një intervali të sigurt.

	Kur të përzgjidhet funksioni ndihmës i Programit të përshtatur, rendimenti i larjes dhe konsumi i energjisë do të jenë të ndryshme nga vlera e deklaruar.

4.3.8.2 Funksionet/programet e zgjedhura duke shtypur butonat e funksioneve për 3 sekonda

• Drum Clean+(Pastrimi i kazanit+ 3") 3"

Shtypni dhe mbani shtypur butonin 1 të funksionit ndihmës për 3 sekonda, për të zgjedhur programin. Përdoreni rregullisht (një herë në çdo 1-2 muaj) për të pastruar kazanin dhe për të siguruar higjienën e kërkuar. Vëreni programin në punë kur pajisja është komplet bosh. Për të arritur rezultate më të mira, futni dekalcifikues për makina larëse kur të përzgjidhet funksioni i detergjentit pluhur. Kur programi të ketë mbaruar, lëreni derën e ngarkimit të hapur në mënyrë që pjesa e brendshme e lavatriçes të thahet.

	Ky nuk është një program larjeje. Është një program mirëmbajtjeje.
	Mos e vini programin në punë kur ka diçka në pajisje. Nëse përpiqeni të bëni këtë, pajisja dallon që ka ngarkesë brenda dhe e ndërpret programin.

• Anti-rrudhë+ 3"

Ky funksion zgjidhet kur shtypet butoni përzgjedhës i centrifugimit për 3 sekonda dhe ndizet drita pasuese e programit për hapin përkatës. Kur të përzgjidhet funksioni, kazani rrotullohet deri në 8 orë për të parandaluar rrudhosjen e rrobave në fund të programit. Mund të anuloni programin dhe t'i nxirrni rrobat në çdo kohë gjatë periudhës 8-orëshe. Shtypni butonin e zgjedhjes së funksionit ose butonin aktiv/joaktiv të pajisjes për ta anuluar funksionin. Drita pasuese e programit do të qëndrojë e ndezur derisa të anulohet funksioni ose të përfundojë hapi. Nëse funksioni nuk mund të anulohet, ai do të jetë aktiv edhe në ciklet e larjeve të mëvonshme.

• **Shpëlarje Ekstra** 3″

Ky funksion zgjidhet kur shtypet butoni i funksionit ndihmës 2 dhe mbahet shtypur për 3 sekonda.
Ky funksion bën të mundur që pajisja të bëjë një shpëlarje tjetër përveç asaj të bërë tashmë pas larjes kryesore. Prandaj, rreziku që lëkurat e ndjeshme (bebet, lëkurat alergjike, etj.) të ndikohen nga mbetjet minimale të detergjentit mbi rroba mund të pakësohet.

• **Kyçi për fëmijët** 3″

Përdorni funksionin e Kyçit për fëmijët për të mos i lejuar ata të ngacmojnë pajisjen. Kështu mund të shmangni ndonjë ndryshim të programit që është në punë.

	Mund ta ndizni dhe fikni makinën larëse me butonin Aktiv/Joaktiv kur Kyçi për fëmijët është aktiv. Kur e ndizni përsëri lavatriçen, programi do të vazhdojë punën që aty ku ndaloi.
	Kur kyçi për fëmijët është i aktivizuar, do të lëshohet një tingull paralajmërues nëse shtypen butonat. Tingulli paralajmërues do të anulohet nëse butonat shtypen pesë herë me radhë.

Për të aktivizuar kyçin për fëmijët:
Shtypni dhe mbani shtypur butonin e funksionit ndihmës 3 për 3 sekonda. Pas numërimit mbrapsht ndërsa **"CL 3-2-1"** në ekran ka mbaruar, Simboli "CL On" (Kyçi për fëmijët i aktivizuar) shfaqet në ekran. Mund ta lëshoni **butonin e funksionit ndihmës 3** kur shfaqet ky paralajmërim.
Për të çaktivizuar kyçin për fëmijët:
Shtypni dhe mbani shtypur butonin e funksionit ndihmës 3 për 3 sekonda. Pas numërimit mbrapsht ndërsa **"CL 3-2-1"** në ekran ka mbaruar, Simboli "CL Off" (Kyçi për fëmijët i çaktivizuar) shfaqet në ekran.

• **Bluetooth 3"** 3″

Mund të përdorni funksionin e lidhjes Bluetooth për të çiftuar kompjuterin tuaj me pajisjen tuaj inteligjente. Në këtë mënyrë, mund të përdorni pajisjen tuaj inteligjente për të marrë informacion në lidhje me lavatriçen tuaj dhe ta komandoni atë.
Për të aktivizuar lidhjen Bluetooth:
Shtypni dhe mbani shtypur butonin e funksionit të telekomandës për 3 sekonda. Do të shfaqet numërimi mbrapsht **"3-2-1"** dhe pastaj do të shfaqet ikona "On" në ekran. Lëshoni **butonin e funksionit të telekomandës**. Ikona e Bluetooth do të ndizet ndërsa produkti po lidhet me pajisjen inteligjente. Nëse lidhja bëhet me sukses, ikona do të mbetet e ndezur.
Për të çaktivizuar lidhjen Bluetooth:
Shtypni dhe mbani shtypur butonin e funksionit të telekomandës për 3 sekonda. Do të shfaqet numërimi mbrapsht **"3-2-1"** dhe pastaj do të shfaqet ikona "Off" në ekran.

	Konfigurimi i parë i aplikacionit HomeWhiz duhet të jetë i plotë për të aktivizuar lidhjen Bluetooth. Pas konfigurimit, shtypja e butonit të funksionit të telekomandës, ndërsa çelësi është në Programin Shkarko/pozicioni i telekomandës, do të aktivizojë automatikisht lidhjen Bluetooth.


4.3.9 Koha e Mbarimit

Shfaqja e orës


Koha e mbetur për përfundimin e programit që është në punë e sipër shfaqet si "01:30" në format orësh dhe minutash.

	Koha e programit mund të jetë e ndryshme nga vlerat në tabelën "Tabela e programeve dhe konsumit" në varësi të presionit të ujit, kripërave dhe temperaturës të ujit, temperaturës të ambientit, sasisë dhe llojit të rrobave, funksioneve ndihmëse të zgjedhura dhe luhatjeve të tensionit.

Me funksionin **Koha e mbarimit**, nisja e programit mund të shtyhet deri në 24 orë. Pasi të keni shtypur butonin **Koha e mbarimit** shfaqet koha e llogaritur e mbarimit të programit. Nëse rregullohet **Koha e mbarimit**, ndizet treguesi **Koha e Mbarimit** .



Me qëllim që funksioni Koha e Mbarimit të aktivizohet dhe programi të mbarojë në fund të kohës të caktuar, duhet të shtypni butonin **Fillo/Pusho** pasi të keni rregulluar kohën.



Nëse dëshironi të anuloni funksionin Koha e mbarimit, kthejeni çelësin në pozicionin e **ndezjes dhe të fikjes**.

Kur të keni aktivizuar funksionin Koha e mbarimit, mos shtoni detergjent të lëngshëm në ndarësin e detergjentit të pluhurit nr. 2. Ekziston rreziku i njollosjes të rrobave.

1 Hapeni derën e ngarkimit, vendosni rrobat dhe hidhni detergjent, etj.
2 Zgjidhni programin e larjes, temperaturën, shpejtësinë e centrifugimit, dhe nëse kërkohet, edhe funksionet ndihmëse.
3 Vendosni kohën e mbarimit sipas dëshirës duke shtypur butonin **Koha e mbarimit**. Ndizet treguesi **Koha e mbarimit**.
4 Shtypni butonin **Fillo/Pusho** . Fillon numërimi mbrapsht i kohës. Shenja ":" në mes të kohës së mbarimit në ekran fillon të pulsojë.

Rroba të tjera mund të shtohen në pajisje gjatë përfundimit të Kohës së mbarimit. Në fund të numërimit mbrapsht, treguesi i Kohës së mbarimit fiket, cikli i larjes fillon dhe koha e programit të zgjedhur shfaqet në ekran.


Kur përfundohet Koha e mbarimit, shfaqet koha në ekran që përbëhet nga koha e mbarimit plus kohëzgjatjen e programit të zgjedhur.

4.3.10 Nisja e programit

1 Shtypni butonin **Fillo/Pusho** për të nisur programin.
2 Butoni **Fillo/Pusho**, i cili ishte i fikur më parë, tani mbetet i ndezur duke treguar që programi ka filluar.



3 Dera e ngarkimit kyçet. Simboli i kyçjes së derës shfaqet në ekran pasi dera e ngarkimit të jetë mbyllur.



4 Dritat treguese të ndjekjes së programit në ekran do të tregojnë hapin aktual të programit.

4.3.11 Kyçja e derës

Ka një sistem kyçi në derën e ngarkimit të pajisjes që parandalon hapjen e derës së ngarkimit në rastet kur niveli i ujit është i papërshtatshëm.
Simboli "Dera e kyçur" shfaqet në ekran kur dera e ngarkimit të jetë kyçur.




Nëse përzgjidhet funksioni i telekomandës, dera do të kyçet. Në mënyrë që të hapni derën, duhet të çaktivizoni funksionin e telekomandës duke shtypur butonin Fillo të telekomandës ose duke ndryshuar pozicionin e programit.


Hapja e derës në rast të ikjes së korrentit:

Në rast të ikjes së korrentit, mund të përdorni dorezën e emergjencës së derës nën kapakun e filtrit të pompës për të hapur me dorë derën e ngarkimit.

PARALAJMËRIM: Për të shmangur çdo rrjedhje uji përpara se të hapni derën e ngarkimit, sigurohuni që nuk ka mbetur ujë brenda pajisjes.



- Hapni kapakun e filtrit të pompës.




- Lëshoni dorezën e emergjencës së derës të vendosur në anën e pasme të kapakut të filtrit.
- Tërhiqeni dorezën e emergjencës së derës së ngarkimit dhe hapni këtë të fundit. Pas hapjes së derës së ngarkimit, rivendosni përsëri dorezën e emergjencës së derës së ngarkimit.
- Nëse dera e ngarkimit nuk hapet, provoni përsëri duke tërhequr poshtë dorezën.


4.3.12 Ndryshimi i përzgjedhjeve pasi programi të ketë nisur

Shtimi i rrobave pasi ka filluar programi :

Nëse niveli i ujit në pajisje është i përshtatshëm kur shtypni butonin Fillo/Pusho, kyçi i derës do të çaktivizohet dhe dera do të hapet, duke ju lejuar të shtoni rrobat. Ikona e kyçjes së derës fiket në ekran kur kyçja e derës është çaktivizuar. Pas shtimit të rrobave, mbyllni derën dhe shtypni butonin **Fillo/Pusho** përsëri për të rifilluar ciklin e larjes.




Nëse niveli i ujit në pajisje është i përshtatshëm kur shtypni butonin Fillo/Pusho, kyçi i derës nuk mund të çaktivizohet dhe ikona e kyçjes së derës në ekran do të mbetet e ndezur.



Nëse temperatura e ujit brenda lavatriçes është mbi 50°C, nuk mund të çaktivizoni kyçin e derës për arsye sigurie, edhe nëse niveli i ujit është i përshtatshëm.

Kalimi i pajisjes në modalitetin e pushimit:

Shtypni butonin Fillo/Pusho për ta kaluar pajisjen në gjendje pauze. Simboli i pauzës do të pulsojë në ekran.



Ndryshimi i zgjedhjes së programit pasi ka filluar programi:

Ndryshimi i programit nuk lejohet kur programi aktual është në punë përveçse nëse aktivizohet kyçja për fëmijët. Ky veprim do të anulojë programin aktual.

	Programi i zgjedhur fillon nga e para.

Ndryshimi i funksionit ndihmës, shpejtësisë dhe temperaturës

Në varësi të fazës në të cilën ka arritur programi, mund të anuloni apo aktivizoni funksionet ndihmëse. Shikoni "Përzgjedhja e funksioneve ndihmëse"

Gjithashtu mund të ndryshoni cilësimet e shpejtësisë dhe temperaturës. Shikoni "Zgjedhja e shpejtësisë" dhe "Zgjedhja e temperaturës".

	Dera e ngarkimit nuk hapet nëse temperatura e ujit në lavatriçe është e lartë ose niveli i ujit është mbi vijën e poshtme të derës të ngarkimit.

4.3.13 Anulimi i programit

Programi anulohet kur butoni i përzgjedhjes së programit është kthyer në një program tjetër ose pajisja është fikur dhe ndezur përsëri duke përdorur butonin e përzgjedhjes së programit.

	Nëse shtypni butonin Aktiv/Joaktiv kur Kyçja për fëmijët është e aktivizuar, programi nuk do të anulohet. Më parë duhet të anuloni Kyçin për Fëmijët.
	Nëse doni ta hapni derën pasi keni anuluar programin por nuk është e mundur ta hapni derën e ngarkimit meqenëse niveli i ujit në lavatriçe është mbi vijën e poshtme të derës, atëherë rrotulloni çelësin e Zgjedhjes së programit në programin Pump+Spin (Pompë+Centrifugim) dhe zbrazeni ujin në lavatriçe.

4.3.14 Përfundimi i programit

Simboli i përfundimit shfaqet në ekran kur programi ka mbaruar.

Nëse nuk shtypni asnjë buton për 10 minuta, pajisja do të kalojë në modalitetin joaktiv. Ekrani dhe të gjithë treguesit fiken.

Hapat e përfunduar të programit do të shfaqen nëse shtypni butonin Aktiv/Joaktiv.

4.3.15 Funksioni HomeWhiz dhe funksioni i telekomandës

HomeWhiz ju lejon ta përdorni pajisjen tuaj inteligjente për të kontrolluar lavatriçen dhe për të marrë informacione në lidhje me statusin e saj. Me aplikacionin HomeWhiz mund ta përdorni pajisjen tuaj inteligjente për të kryer procedura të ndryshme që mund të kryhen edhe në pajisje. Plus, mund të përdorni disa funksione vetëm me funksionin HomeWhiz.

Duhet të shkarkoni aplikacionin HomeWhiz nga dyqani i aplikacioneve të pajisjes suaj inteligjente për të përdorur veçorinë Bluetooth të pajisjes suaj.

Sigurohuni që pajisja juaj inteligjente është lidhur me internetin për të instaluar aplikacionin.

Nëse po e përdorni aplikacionin për herë të parë, ndiqni udhëzimet në ekran për të përfunduar regjistrimin e llogarisë suaj të përdoruesit. Sapo të përfundojë procedura e regjistrimit, mund t'i përdorni të gjithë produktet e shtëpisë tuaj që janë të pajisura me funksionin HomeWhiz, me këtë llogari.

Mund të prekni funksionin "Shto/Hiq pajisjen" të aplikacionit HomeWhiz për të parë produktet e lidhura me llogarinë tuaj. Në këtë faqe mund të kryeni procedurat e lidhjes së përdoruesve të këtyre produkteve.

	Për të përdorur funksionin HomeWhiz, aplikacioni duhet të instalohet në pajisjen tuaj inteligjente dhe lavatriçja duhet të çiftohet me pajisjen tuaj inteligjente nëpërmjet funksionit bluetooth. Nëse lavatriçja nuk është çiftuar me pajisjen tuaj inteligjente, ajo funksionon si një pajisje që nuk e ka një veçorinë HomeWhiz.
	Pajisja juaj do të funksionojë si e çiftuar me pajisjen tuaj inteligjente nëpërmjet funksionit Bluetooth. Kontrollet e bëra me anë të aplikacionit do të mundësohen nëpërmjet këtij çiftimi; prandaj fuqia e sinjalit bluetooth midis lavatriçes dhe pajisjes inteligjente duhet të jetë e përshtatshme.
	Ju lutemi të vizitoni www.homewhiz.com për të parë versionet Android dhe iOS të mundësuara nga aplikacioni HomeWhiz.

	PARALAJMËRIM: Të gjitha masat e sigurisë të përshkruara në seksionin **"UDHËZIMET E PËRGJITHSHME TË SIGURISË"** të manualit tuaj të përdorimit zbatohen edhe për funksionimin në distancë përmes funksionit HomeWhiz.


4.3.15.1 Konfigurimi i HomeWhiz

Për të përdorur aplikacionin, duhet të krijohet një lidhje midis pajisjes suaj dhe aplikacionit HomeWhiz. Për të krijuar këtë lidhje duhet të ndiqni hapat e mëposhtëm për procedurën e konfigurimit në të dy pajisjet dhe në aplikacionin HomeWhiz.


- Nëse po shtoni një pajisje për herë të parë, prekni butonin "Shto/Hiq pajisjen" në aplikacionin HomeWhiz.

Pas këtij hapi prekni "Prek këtu për të konfiguruar një pajisje të re". Ndiqni hapat më poshtë si dhe hapat në aplikacionin Homewhiz për të kryer konfigurimin.

• Për të filluar konfigurimin, sigurohuni që lavatriçja juaj të jetë e fikur. Shtypni dhe mbani shtypur butonin e temperaturës dhe butonin e telekomandës në të njëjtën kohë për 3 sekonda, për të kaluar lavatriçen në modalitetin e konfigurimit HomeWhiz.



• Kur pajisja është në modalitetin e konfigurimit HomeWhiz, do të shihni një animacion në ekran dhe ikona bluetooth do të ndizet derisa lavatriçja të çiftohet me pajisjen inteligjente. Vetëm çelësi i programit do të jetë aktiv në këtë modalitet. Butonat e tjerë do të jenë joaktivë.



• Në ekranin që shihni në aplikacion, zgjidhni lavatriçen dhe shtypni vazhdo.
• Vazhdoni të lexoni udhëzimet në ekran derisa HomeWhiz t'ju kërkojë për produktin që dëshironi të lidhni me pajisjen tuaj inteligjente.
• Nëse lavatriçja juaj çiftohet me sukses me pajisjen tuaj, ekrani juaj do të kalojë automatikisht në modalitetin normal dhe ikona bluetooth do të mbetet e ndezur ndërsa dëgjoni një melodi të suksesshme të konfigurimit nga pajisja.
• Kthehuni në aplikacionin HomeWhiz dhe prisni derisa të përfundojë konfigurimi. Kur konfigurimi të ketë përfunduar, caktojini një emër lavatriçes suaj. Tani, mund të prekni dhe të shikoni produktin që keni shtuar në aplikacionin HomeWhiz.

Nëse nuk mund ta kryeni konfigurimin me sukses brenda 5 minutave, lavatriçja juaj do të fiket automatikisht. Në këtë rast, do të duhet të filloni procedurën e konfigurimit nga e para. Nëse problemi vazhdon kontaktoni Agjentin e Autorizuar të Shërbimit.

Mund ta përdorni lavatriçen tuaj me më shumë se një pajisje inteligjente. Për ta bërë këtë, shkarkoni aplikacionin HomeWhiz në pajisjen tjetër inteligjente. Kur të nisni aplikacionin, do të duhet të identifikoheni me llogarinë që keni krijuar më parë dhe të çiftuar me lavatriçen tuaj. Përndryshe, ju lutemi lexoni "Konfigurimi i lavatriçes që është e lidhur me llogarinë e dikujt tjetër".

PARALAJMËRIM: Ju duhet lidhje në internet në pajisjen tuaj inteligjente për të vazhduar me konfigurimin HomeWhiz. Përndryshe, aplikacioni HomeWhiz nuk do t'ju lejojë të përfundoni me sukses procedurën e konfigurimit. Ju lutemi të kontaktoni ofruesin e shërbimit të internetit nëse keni probleme me lidhjen tuaj në internet.



Aplikacioni HomeWhiz mund t'ju kërkojë të shkruani numrin e produktit të dhënë në etiketën e produktit. Etiketën e produktit mund ta gjeni brenda derës së pajisjes. Numri i produktit do të shfaqet në etiketë.



4.3.15.2 Konfigurimi i lavatriçes që është e lidhur me llogarinë e dikujt tjetër

Nëse lavatriçja që dëshironi të përdorni është paraqitur më parë në sistem me llogarinë e dikujt tjetër, duhet të krijoni një lidhje të re ndërmjet aplikacionit tuaj HomeWhiz dhe pajisjes.

• Shkarkoni aplikacionin HomeWhiz në pajisjen e re inteligjente që dëshironi të përdorni.
• Krijoni një llogari të re dhe hyni në këtë llogari në aplikacionin HomeWhiz.
• Ndiqni hapat e përshkruar në konfigurimin e HomeWhiz (4.3.15.1 Konfigurimi i HomeWhiz) dhe vazhdoni me procedurën e konfigurimit.

Meqenëse funksioni HomeWhiz dhe funksioni i telekomandës në pajisjen tuaj funksionon nëpërmjet çiftimit duke përdorur teknologjinë Bluetooth, vetëm një aplikacion i Homewhiz mund të veprojë në të njëjtën kohë.

PARALAJMËRIM: Ekziston një kufi për pajisjet inteligjente që mund të lidhen me lavatriçen. Nëse tejkalohet ky kufi, pajisja e parë e lidhur do të fshihet nga lista e pajisjeve të çiftuara në lavatriçe dhe do të duhet të përsërisni procedurën e konfigurimit në atë pajisje inteligjente.

4.3.15.3 Funksioni i telekomandës dhe përdorimi i saj

Pas konfigurimit të HomeWhiz, Bluetooth do të ndizet automatikisht. Për të aktivizuar ose çaktivizuar lidhjen me Bluetooth, shihni 4.3.8.2 Bluetooth 3''.


Nëse e fikni dhe e ndizni pajisjen tuaj ndërsa Bluetooth është aktiv, ajo do të rilidhet automatikisht. Në rastet kur pajisja e çiftuar del jashtë fushës së sinjalit, Bluetooth do të fiket automatikisht. Për këtë arsye, do të duhet të aktivizoni përsëri funksionin Bluetooth nëse dëshironi të përdorni funksionin e telekomandës.

Mund të kontrolloni simbolin e Bluetooth në ekran për të ndjekur gjendjen tuaj të lidhjes. Nëse simboli është vazhdimisht i aktivizuar, jeni të lidhur me Bluetooth. Nëse simboli pulson, pajisja po përpiqet të lidhet. Nëse simboli është i fikur, nuk jeni të lidhur.

PARALAJMËRIM: Kur lidhja me Bluetooth është aktive në produktin tuaj, funksioni i telekomandës e mundëson zgjedhjen.
Nëse funksioni i telekomandës nuk mund të zgjidhet, kontrolloni gjendjen e lidhjes. Nëse lidhja nuk mund të krijohet, përsëritni cilësimet e konfigurimit fillestar në pajisje.

PARALAJMËRIM: Për arsye sigurie, dera e produktit do të mbetet e kyçur, ndërsa funksioni i telekomandës është i aktivizuar, pavarësisht nga modaliteti i funksionimit. Nëse dëshironi të hapni derën e pajisjes, do të duhet ta ktheni çelësin e përzgjedhjes së programit ose të shtypni çelësin e telekomandës për të çaktivizuar funksionin e kontrollit të telekomandës.

Kur doni ta kontrolloni lavatriçen nga distanca, duhet të aktivizoni funksionin e telekomandës duke shtypur butonin e telekomandës ndërsa çelësi i programit është në pozicionin e butonit të Shkarko programin/pozicioni i telekomandës në panelin e kontrollit të lavatriçes suaj. Kur të keni qasje në pajisjen tuaj, do të shihni një ekran të ngjashëm si më poshtë.



Kur kontrolli i telekomandës është aktiv, mund të menaxhoni vetëm proceset e fikjes dhe të ndjekjes së statusit përmes lavatriçes tuaj. Gjithashtu të gjitha funksionet përveç kyçit për fëmijët mund të menaxhohen përmes aplikacionit.

Mund të ndiqni nëse funksioni i telekomandës është i ndezur ose i fikur përmes treguesit të funksionit në buton.

Nëse funksioni i telekomandës është i fikur, të gjitha proceset kryhen në lavatriçe dhe vetëm në aplikacion lejohet vetëm ndjekja e statusit.

Në rast se funksioni i fillimit përmes telekomandës nuk mund të aktivizohet, pajisja do të lëshojë një tingull paralajmërues kur të shtypni butonin. Kjo mund të ndodhë në rastet kur pajisja është e ndezur dhe nuk ka pajisje inteligjente të çiftuara me Bluetooth. Disa shembuj të këtyre rasteve janë cilësimet e funksionit Bluetooth të fikura ose dera e lavatriçes e hapur.

Pasi ta aktivizoni këtë funksion në lavatriçe, ai do të mbetet i aktivizuar përveç disa rasteve të caktuara dhe do t'ju lejojë ta kontrolloni në distancë lavatriçen tuaj me Bluetooth.

Në raste të caktuara, ai çaktivizohet për arsye sigurie:

- Kur lavatriçja i nënshtrohet një ndërprerjeje të energjisë.
- Kur çelësi i programit është i rrotulluar dhe është zgjedhur një program i ndryshëm ose pajisja është fikur.

4.3.15.4 Zgjidhja e problemeve

Veproni si më poshtë nëse keni ndonjë problem me kontrollin ose lidhjen. Vëzhgoni nëse problemi vazhdon ose jo pas veprimit që keni kryer. Veproni si më poshtë nëse problemi nuk zgjidhet.


- Kontrolloni nëse pajisja juaj inteligjente është e lidhur me rrjetin përkatës në shtëpi.
- Rindizni sërish aplikacionin e pajisjes.
- Fikeni Bluetooth dhe pastaj ndizeni nëpërmjet panelit të kontrollit të përdoruesit.
- Nëse lidhja nuk mund të krijohet me proceset e mësipërme, përsëritni cilësimet e konfigurimit fillestar në pajisje.

Nëse problemi vazhdon, kontaktoni Agjentin e Autorizuar të Shërbimit.

4.4 Mirëmbajtja dhe pastrimi

Jetëgjatësia e shërbimit të produktit zgjatet dhe problemet e hasura shpesh pakësohen nëse pastrohet në intervale të rregullta.

4.4.1 Pastrimi i sirtarit të detergjentit



Pastroni sirtarin e detergjentit në intervale të rregullta (çdo 4-5 cikle larjeje) siç tregohen më poshtë me qëllim që të parandaloni grumbullimin e pluhurit të detergjentit me kalimin e kohës.

Ngrite pjesën e pasme të sifonit për ta hequr ashtu siç është ilustruar.

Nëse fillon të mblidhet një sasi më e madhe se normalja përzierje uji dhe zbutësi në ndarësen e zbutësit, sifoni duhet të pastrohet.

1 Shtypni pikën të shënjuar të cila gjendet në sifoni brenda pjesës për zbutuesve dhe tërheqni në drejtimin juaj deri sa pjesa është jashtë makinës larëse.

2. Pastroni sirtarin e detergjentit dhe sifonin me shumë ujë të vakët në një lavaman. Për të mos lejuar mbetjet të bien në kontakt me lëkurën, pastrojeni me një furçë të përshtatshme duke veshur një palë doreza.

3 Vendosni sirtarin në vendin e tij pas pastrimit dhe sigurohuni që të mbyllet plotësisht.

4.4.2 Pastrimi i derës së ngarkesës dhe kazanit

Për produktet me program për pastrimin e kazanit, ju lutem shikoni Përdorimi i produktit – Programet.

	Përsëriteni procesin e Pastrimit të Kazanit çdo 2 muaj,
	Përdorni një kundër-gëlqeror të përshtatshëm për makinat larëse.



Pas çdo larjeje sigurohuni që të mos lini asnjë substancë të huaj në kazan.

Nëse vrimat në fryrësin e treguar në figurë janë të bllokuara, hapini duke përdorur një kruajtëse dhëmbësh.

Substancat e metaleve të huaja do të shkaktojnë njolla ndryshku në kazan. Pastroni njollat mbi sipërfaqen e kazanit duke përdorur agjentë pastrues për çelikun e pandryshkshëm.

Kurrë mos përdorni lesh çeliku ose lesh teli. Kjo do të dëmtojë sipërfaqet e lyera, të kromuara dhe plastike.


4.4.3 Pastrimi i trupit dhe panelit të kontrollit

Fshijeni trupin e makinerisë me ujë me sapun ose detergjentë xhel të butë siç duhet, dhe thajeni me një copë të butë.

Përdorni vetëm një copë të butë të thatë për të pastruar panelin e kontrollit.

4.4.4 Pastrimi i filtrave të marrjes së ujit

Ka një filtër në fund të çdo valvule për marrjen e ujit në pjesën e pasme të makinerisë dhe gjithashtu në të fund të çdo tubi të marrjes së ujit që janë të lidhur me rubinetin. Këta filtra parandalojnë hyrjen e substancave të huaja dhe papastërtive të ujit në makinën larëse. Filtrat duhet të pastrohen sepse bëhen pis.



1. Mbyllni rubinetet.
2. Hiqni vidat nga tubat e shkarkimit të ujit për të arritur filtrat në valvulat e marrjes së ujit. Fshijni ata me një furçë të përshtatshme. Nëse filtrat janë shumë të pistë, hiqini nga vendet me një pincë dhe pastrojini në këtë mënyrë.
3 Hiqini filtrat në pjesët fundore të sheshta të tubave të marrjes së ujit bashkë me rondelet dhe pastrojini tërësisht me ujë të rrjedhshëm.
4. Vendosini përsëri izoluesit dhe filtrat me kujdes dhe shtrëngojini vidat me dorë.

4.4.5 Shkarkimi i ujit të mbetur dhe pastrimi i filtrit të pompës

Sistemi i filtrimit në makinerinë tuaj parandalon artikujt e ngurtë të tilla si kopsat, monedhat dhe fibrat e materialeve që të bllokojnë rrotullimin e pompës gjatë shkarkimit të ujit. Në këtë mënyrë, uji do të shkarkohet pa ndonjë problem dhe jeta e shërbimit të pompës do të zgjatet.
Nëse makineria nuk e bën shkarkimin e ujit, filtri i pompës është i bllokuar. Filtri duhet të pastrohet kur ai bllokohet ose çdo 3 muaj. Uji duhet të shkarkohet paraprakisht për të pastruar filtrin e pompës.
Përveç kësaj, para se të transportoni makinerinë (p.sh. kur lëvizni në një shtëpi tjetër) dhe në rastin e ujit të ngrirë, uji mund të duhet që të shkarkohet plotësisht.


⚠	**KUJDES:** Substancat e huaja të lëna në filtrin e pompës mund të dëmtojnë makinerinë tuaj ose mund të shkaktojnë probleme të zhurmës.
	KUJDES: Nëse produkti nuk përdoret, mbylleni rubinetin, hiqni tubin e hyrjes të ujit dhe shkarkoni ujin brenda makinës larëse për të mos lejuar ngrirjen.
	KUJDES: Pas çdo përdorimi, mbyllni rubinetin e ujit me të cilin lidhet tubacioni i ujit.

Me qëllim që të pastroni filtrin e pistë dhe të shkarkoni ujin:

1 Hiqeni nga priza makinën larëse për të ndalin furnizimin me uji.


⚠	**KUJDES:** Temperatura e ujit brenda makinerisë mund të ngrihet deri në 90 ºC. Për të shmangur rrezikun e djegies, pastroni filtrin pasi uji brenda makinës larëse të jetë ftohur.

2. Hapni kapakun e filtrit.



3 Ndiqni procedurat e mëposhtme për të zbrazur ujin.

Nëse produkti nuk ka një tub të shkarkimit emergjent, atëherë për të shkarkuar ujin:



a. Për të grumbulluar ujin që të dalë nga filtri, vendosni një enë të madhe përballë filtrit.
b. Rrotulloni dhe lironi filtrin e pompës derisa të fillojë të dalë uji (kundërorar). Futeni ujin që rrjedh në enën që vendosët përballë filtrit. Mbani gjithmonë një copë leckë të dobishme për të thithur ujin që del jashtë.
c Kur uji brenda makinerisë mbaron, hiqeni filtrin tërësisht duke e rrotulluar.

4 Pastroni ndonjë mbetje brenda filtrit dhe gjithashtu fibrat, nëse ka, rrotull zonës së rrotulluesit të pompës.
5. Vendosni filtrin.
6. Nëse kapaku i filtrit është i përbërë nga dy pjesë, mbylleni kapakun e filtrit duke shtypur mbi kllapë. Nëse është me një pjesë, në fillim vendosni kllapat në pjesën e poshtme në vendet e tyre, pastaj shtypeni pjesën e sipërme për ta mbyllur.

5 Zgjidhja e problemeve

Problemi	Shkaku	Zgjidhja
Programet nuk fillojnë pasi është mbyllur dera e ngarkimit.	Nuk është shtypur butoni Start/Pause/Cancel.	• Shtypni butonin Start/Pause/Cancel.
	Mund të jetë e vështirë ta mbyllni derën e ngarkimit në rast të një mbingarkese.	• Zvogëloni sasinë e rrobave dhe sigurohuni që dera e ngarkimit të mbyllet si duhet.
Programi nuk mund të niset apo përzgjidhet.	Produkti ka kaluar në modalitetin e vetëmbrojtjes për shkak të një problemi furnizimi (tensioni i rrjetit, presioni i ujit etj.)	• Për ta anuluar programin, rrotullojeni çelësin e Përzgjedhjes së programit duke përzgjedhur një program tjetër. Programi i mëparshëm do të anulohet. (shiko"Anulimi i programit")
Ka ujë brenda produktit.	Ka mbetur pak ujë në produkt për shkak të proceseve të kontrollit të cilësisë gjatë prodhimit.	• Ky nuk është një defekt; uji nuk është i dëmshëm për produktin.
Produkti nuk merr ujë.	Rubineti është i mbyllur.	• Hapni rubinetët.
	Tubi i furnizimit të ujit është i përthyer.	• Shtrijeni tubin.
	Filtri i hyrjes së ujit është bllokuar.	• Pastrojeni filtrin.
	Dera e ngarkimit nuk është mbyllur.	• Mbylleni derën.
Produkti nuk e shkarkon ujin.	Tubi i shkarkimit të ujit është bllokuar ose përdredhur.	• Pastrojeni ose shtrijeni tubin.
	Filtri i pompës është bllokuar.	• Pastroni filtrin e pompës.
Produkti dridhet ose bën zhurmë.	Produkti po qëndron i pabalancuar.	• Stabilizojeni produktin duke rregulluar këmbët.
	Një substancë e fortë ka hyrë në filtrin e pompës.	• Pastroni filtrin e pompës.
	Bulonat e sigurisë së transportit nuk janë hequr.	• Hiqni bulonat e sigurisë së transportit.
	Sasia e rrobave në produkt është shumë e vogël.	• Shtoni më shumë rroba në produkt.
	Janë futur tepër rroba në produkt.	• Nxirrni disa prej rrobave nga produkti ose shpërndajeni ngarkesën me dorë për ta balancuar njëlloj në produkt.
	Produkti po anohet mbi diçka të fortë.	• Sigurohuni që produkti të mos anohet mbi asgjë.
Ka rrjedhje uji nga fundi i produktit.	Tubi i shkarkimit të ujit është bllokuar ose përdredhur.	• Pastrojeni ose shtrijeni tubin.
	Filtri i pompës është bllokuar.	• Pastroni filtrin e pompës.
Produkti ndaloi pak pasi nisi programi.	Produkti ka ndaluar përkohësisht për shkak të tensionit të ulët.	• Produkti do të vazhdojë të punojë kur tensioni të rikthehet në nivelin normal.
Produkti e shkarkon direkt ujin që merr.	Tubi i shkarkimit nuk është në lartësinë e duhur.	• Lidhni tubin e shkarkimit të ujit siç tregohet në manualin e përdorimit.
Në produkt nuk duket ujë gjatë larjes.	Uji është brenda pjesës që nuk duket të produktit.	• Ky nuk është defekt.
Dera e ngarkimit nuk mund të hapet.	Është aktivizuar kyçja e derës së ngarkimit për shkak të nivelit të ujit në produkt.	• Zbrazeni ujin duke vënë në punë programin e Pompës ose Centrifugimit.
	Produkti po ngroh ujin ose është në ciklin e centrifugimit.	• Prisni derisa programi të mbarojë.
	Dera e ngarkimit mund të ngecë për shkak të presionit të ushtruar mbi të.	• Kapeni dorezën dhe shtyjeni dhe tërhiqeni derën e ngarkimit për ta liruar dhe për ta hapur.
	Nëse nuk ka energji, dera e ngarkimit të produktit nuk do të hapet.	• Për të hapur derën e ngarkimit, hapni kapakun e filtrit të pompës dhe ulni poshtë dorezën e emergjencës që ndodhet në anën e pasme të kapakut të lartpërmendur. Shihni "Kyçja e derës së ngarkimit"

Problemi	Shkaku	Zgjidhja
Larja kërkon më shumë kohë nga sa tregohet në manualin e përdorimit.(*)	Presioni i ujit është i ulët.	• Produkti pret derisa të marrë sasinë e duhur të ujit për të parandaluar cilësinë e dobët të larjes për shkak të sasisë të pakët të ujit. Prandaj, koha e larjes zgjat më shumë.
	Tensioni është i ulët.	• Koha e larjes zgjatet për të shmangur rezultate të dobëta të larjes kur tensioni është i ulët.
	Temperatura e ujit që hyn është e ulët.	• Koha që kërkohet për të ngrohur ujin zgjat më shumë në stinët e ftohta. Gjithashtu, koha e larjes mund të zgjatet për të shmangur rezultate të dobëta të larjes.
	Numri i shpëlarjeve dhe/ose sasia e ujit për shpëlarje është rritur.	• Produkti rrit sasinë e ujit të shpëlarjes kur nevojitet shpëlarje e mirë dhe shton një hap ekstra shpëlarjeje nëse është e nevojshme.
	Krijohet shkumë e tepërt dhe aktivizohet sistemi automatik i thithjes të shkumës për shkak të përdorimit të tepërt të detergjentit.	• Përdorni sasinë e rekomanduar të detergjentit.
Koha e programit nuk numëron së prapthi. (Në modelet me ekran) (*)	Kohëmatësi mund të ndalojë gjatë marrjes së ujit.	• Treguesi i kohëmatësit nuk do të numërojë së prapthi derisa produkti të marrë sasinë e përshtatshme të ujit. Produkti do të presë derisa të ketë sasi të mjaftueshme uji për të shmangur rezultatet e dobëta të larjes për shkak të mungesës së ujit. Pas kësaj treguesi i kohëmatësit do të rifillojë numërimin së prapthi.
	Kohëmatësi mund të ndalojë gjatë hapit të ngrohjes.	• Treguesi i kohëmatësit nuk do të numërojë së prapthi derisa produkti të ketë arritur temperaturën e përzgjedhur.
	Kohëmatësi mund të ndalojë gjatë fazës të centrifugimit.	• Sistemi i gjurmimit automatik të ngarkesës së pabalancuar vihet në punë për shkak të shpërndarjes së pabalancuar të rrobave në produkt.
Koha e programit nuk numëron së prapthi. (*)	Ka ngarkesë të pabalancuar në produkt.	• Sistemi i gjurmimit automatik të ngarkesës së pabalancuar vihet në punë për shkak të shpërndarjes së pabalancuar të rrobave në produkt.
Produkti nuk kalon në hapin e centrifugimit. (*)	Ka ngarkesë të pabalancuar në produkt.	• Sistemi i gjurmimit automatik të ngarkesës së pabalancuar vihet në punë për shkak të shpërndarjes së pabalancuar të rrobave në produkt.
	Produkti nuk e bën centrifugimin nëse uji nuk zbrazet plotësisht.	• Kontrolloni filtrin dhe tubin e shkarkimit.
	Krijohet shkumë e tepërt dhe aktivizohet sistemi automatik i thithjes të shkumës për shkak të përdorimit të tepërt të detergjentit.	• Përdorni sasinë e rekomanduar të detergjentit.
Rendimenti i larjes është i dobët: Rrobat bëhen gri. (**)	Është përdorur sasi e pamjaftueshme detergjenti për një kohë të gjatë.	• Përdorni sasinë e rekomanduar të detergjentit të përshtatshme për fortësinë e ujit dhe llojin e rrobave.
	Larja është bërë në temperatura të ulëta për kohë të gjatë.	• Zgjidhni temperaturën e duhur për larjen e rrobave.
	Është përdorur sasi e pamjaftueshme detergjenti me ujë të fortë.	• Përdorimi i sasisë së pamjaftueshme të detergjentit me ujë të fortë bën që njollat të ngjiten në rroba dhe kjo i bën rrobat gri me kalimin e kohës. Pasi kjo ndodh, është e vështirë të eliminohet ngjyra gri. Përdorni sasinë e rekomanduar të detergjentit të përshtatshme për fortësinë e ujit dhe llojin e rrobave.
	Është përdorur sasi e tepërt detergjenti.	• Përdorni sasinë e rekomanduar të detergjentit të përshtatshme për fortësinë e ujit dhe llojin e rrobave.

Problemi	Shkaku	Zgjidhja
Rendimenti i larjes është i dobët: Njollat nuk hiqen ose rrobat nuk zbardhen. (**)	Është përdorur sasi e pamjaftueshme detergjenti.	• Përdorni sasinë e rekomanduar të detergjentit të përshtatshme për fortësinë e ujit dhe llojin e rrobave.
	Janë futur tepër rroba.	• Mos e mbushni produktin me tepri. Ngarkoni sasitë e rekomanduara në "Tabela e programeve dhe konsumit".
	Është zgjedhur programi dhe temperatura e gabuar.	• Zgjidhni programin dhe temperaturën e duhur për rrobat që do të lahen.
	Është përdorur lloji i gabuar i detergjentit.	• Përdorni detergjent origjinal të përshtatshëm për produktin.
	Është përdorur sasi e tepërt detergjenti.	• Vendoseni detergjentin në ndarjen e duhur. Mos e përzieni agjentin zbardhues dhe detergjentin me njëri-tjetrin.
Rendimenti i larjes është i dobët: Në rroba janë shfaqur njolla yndyre. (**)	Nuk është bërë pastrimi i zakonshëm i kazanit.	• Pastrojeni kazanin rregullisht. Për këtë procedurë, ju lutemi të shihni "Pastrimi i derës së ngarkimit dhe kazanit".
Rendimenti i larjes është i dobët: Rrobat kanë erë të pakëndshme. (**)	Në kazan formohen erëra dhe shtresa të tilla bakteresh, si rrjedhojë e larjes së vazhdueshme në temperatura të ulëta dhe/ose programe të shkurtra.	• Lëreni sirtarin e detergjentit si dhe derën e mbushjes pak të hapur pas çdo larjeje. Kështu, në makinën larëse nuk krijohet një ambient i lagësht i favorshëm për bakteret.
Ngjyra e rrobave është zbehur. (**)	Janë ngarkuar tepër rroba.	• Mos e mbushni produktin me tepri.
	Detergjenti i përdorur është njomur.	• Mbajini detergjentët në ambiente pa lagështi dhe mos i ekspozoni në temperatura ekstreme.
	Është zgjedhur një temperaturë më e lartë.	• Zgjidhni programin dhe temperaturën e duhur sipas llojit dhe shkallës së ndotjes së rrobave.
Lavatriçja nuk shpëlan mirë.	Sasia, marka dhe kushtet e ruajtjes së detergjentit të përdorur janë të papërshtatshme.	• Përdorni një detergjent të përshtatshëm për larjen në lavatriçe dhe për llojin e rrobave. Mbajini detergjentët në ambiente pa lagështi dhe mos i ekspozoni në temperatura ekstreme.
	Detergjenti është vendosur në ndarjen e gabuar.	• Nëse detergjenti është vendosur në ndarjen e paralarjes, edhe pse nuk është përzgjedhur cikli i paralarjes, produkti mund ta marrë këtë detergjent gjatë hapit të shpëlarjes ose zbutjes. Vendoseni detergjentin në ndarjen e duhur.
	Filtri i pompës është bllokuar.	• Kontrolloni filtrin.
	Tubi i shkarkimit është palosur.	• Kontrolloni tubin e shkarkimit.
Rrobat bëhen të ngurta pas larjes. (**)	Është përdorur sasi e pamjaftueshme detergjenti.	• Përdorimi i një sasie të pamjaftueshme detergjenti për fortësinë e ujit mund të shkaktojë që rrobat të bëhen të ngurta me kalimin e kohës. Përdorni sasinë e duhur të detergjentit sipas fortësisë së ujit.
	Detergjenti është vendosur në ndarjen e gabuar.	• Nëse detergjenti është vendosur në ndarjen e paralarjes, edhe pse nuk është përzgjedhur cikli i paralarjes, produkti mund ta marrë këtë detergjent gjatë hapit të shpëlarjes ose zbutjes. Vendoseni detergjentin në ndarjen e duhur.
	Detergjenti është përzier me zbutës.	• Mos e përzieni zbutësin me detergjentin. Lani dhe pastroni sirtarin me ujë të nxehtë.
Rrobat nuk vijnë erën e zbutësit. (**)	Detergjenti është vendosur në ndarjen e gabuar.	• Nëse detergjenti është vendosur në ndarjen e paralarjes, edhe pse nuk është përzgjedhur cikli i paralarjes, produkti mund ta marrë këtë detergjent gjatë hapit të shpëlarjes ose zbutjes. Lani dhe pastroni sirtarin me ujë të nxehtë. Vendoseni detergjentin në ndarjen e duhur.
	Detergjenti është përzier me zbutës.	• Mos e përzieni zbutësin me detergjentin. Lani dhe pastroni sirtarin me ujë të nxehtë.

Problemi	Shkaku	Zgjidhja
Mbetje detergjenti në sirtarin e detergjentit. (**)	Detergjenti është vendosur në sirtar të njomë.	• Thajeni sirtarin e detergjentit para se të hidhni detergjent.
	Detergjenti është njomur.	• Mbajini detergjentët në ambiente pa lagështi dhe mos i ekspozoni në temperatura ekstreme.
	Presioni i ujit është i ulët.	• Kontrolloni presionin e ujit.
	Detergjenti në ndarjen kryesore të larjes është njomur kur ka marrë ujin për paralarje. Vrimat në ndarjen e detergjentit janë bllokuar.	• Kontrolloni vrimat dhe pastrojini nëse janë bllokuar.
	Ka një problem me valvulat e sirtarit të detergjentit.	• Thërrisni Agjentin e Shërbimit të Autorizuar.
	Detergjenti është përzier me zbutës.	• Mos e përzieni zbutësin me detergjentin. Lani dhe pastroni sirtarin me ujë të nxehtë.
	Nuk është bërë pastrimi i zakonshëm i kazanit.	• Pastrojeni kazanin rregullisht. Për këtë procedurë, ju lutemi të shihni "Pastrimi i derës së ngarkimit dhe kazanit".
Brenda produktit formohet shkumë e tepërt. (**)	Janë përdorur detergjentë të papërshtatshëm për lavatriçe.	• Përdorni detergjentë të përshtatshëm për lavatriçe.
	Është përdorur sasi e tepërt detergjenti.	• Përdorni vetëm sasi të mjaftueshme detergjenti.
	Detergjenti është ruajtur në kushte të papërshtatshme.	• Ruajeni detergjentin në vend të mbyllur dhe të thatë. Mos e ruani në vende tepër të nxehta.
	Disa rroba me rrjetë si tylet mund të shkaktojnë shumë shkumë për shkak të përbërjes së tyre.	• Përdorni sasi më të vogla detergjenti për këta lloj artikujsh.
	Detergjenti është vendosur në ndarjen e gabuar.	• Vendoseni detergjentin në ndarjen e duhur.
	Zbutësi merret shumë herët nga produkti.	• Mund të ketë një problem në valvulat ose në sirtarin e detergjentit. Thërrisni Agjentin e Shërbimit të Autorizuar.
Po del shkumë nga sirtari i detergjentit.	Është përdorur më tepër detergjent sesa duhet.	• Përzieni 1 lugë gjelle zbutës dhe ½ l ujë dhe hidheni në ndarësen e larjes kryesore të sirtarit të detergjentit.
		• Vendosni në produkt detergjent të përshtatshëm me programet dhe ngarkesat maksimale të dhëna në tabelën "Tabela e programeve dhe konsumit". Kur përdorni kimikate shtesë (heqës njollash, zbardhues e kështu me radhë), ulni sasinë e detergjentit.
Rrobat mbeten të lagura në fund të programit. (*)	Krijohet shkumë e tepërt dhe aktivizohet sistemi automatik i thithjes të shkumës për shkak të përdorimit të tepërt të detergjentit.	• Përdorni sasinë e rekomanduar të detergjentit.

(*) Produkti nuk kalon në fazën e centrifugimit nëse rrobat nuk janë shpërndara njëtrajtshmërisht në kazan për të parandaluar ndonjë dëmtim të produktit dhe mjedisit përreth. Rrobat duhet të rregullohen dhe të shtrydhen sërish.

(**) Nuk është bërë pastrimi i zakonshëm i kazanit. Pastrojeni kazanin rregullisht. Shikoni 4.4.2

PARALAJMËRIM: Nëse nuk mund ta eliminoni problemin megjithëse keni ndjekur udhëzimet në këtë seksion, konsultohuni me shitësin ose Agjentin e Shërbimit të Autorizuar. Mos u përpiqni asnjëherë të rregulloni vetë një produkt që nuk funksionon.

PARALAJMËRIM: Kontrolloni seksionin HomeWhiz për informacionet përkatëse lidhur me zgjidhjen e problemeve.

Kur pajisja është e fikur, nëse butonat e funksioneve ndihmëse 1 dhe 2 shtypen për një kohë të gjatë, shfaqet një numërim mbrapsht 3-2-1 dhe shfaqen ciklet totale të larjes të kryera nëpërmjet pajisjes.
Pasi shfaqen ciklet totale të larjes, shfaqen edhe kodet e gabimeve, nëse ka. Kontrolloni informacionin në ekran nëpërmjet tabelës së mëposhtme.

Informacioni në ekran	Shkaku	Zgjidhja
Gabimi	Algoritmi i sigurisë ekzekutohet në pajisje.	Pritni derisa të kalojë teksti. Pasi të shtypni butonat e funksioneve ndihmëse 1 dhe 2, kontrolloni informacionin në ekran.
SC	Ankesa juaj nuk u zgjidh gjatë kontrollit.	Telefononi agjentin e servisit të autorizuar.
E5	Filtri i pompës mund të jetë i bllokuar.	Pastroni filtrin e pompës. Shihni seksionin “Shkarkimi i ujit të mbetur dhe pastrimi i filtrit të pompës”. Provoni në ciklin e centrifugës. Nëse problemi nuk zgjidhet, telefononi servisin.
E8	Pajisja mund të mos marrë ujë.	• Hapni rubinetat. • Sigurohuni që nuk ka ndërprerje të ujit. • Kontrolloni lidhjen e zorrës së hyrjes së ujit; nëse ka ndonjë palosje në zorrë, drejtojeni. • Pastroni filtrin e pompës. Shihni seksionin “Shkarkimi i ujit të mbetur dhe pastrimi i filtrit të pompës”. • Mbyllni kapakun e përparmë të pajisjes. Sigurohuni që kapaku të jetë i kyçur. Vëreni edhe një herë në punë pajisjen. Nëse problemi nuk zgjidhet, telefononi servisin.
E29	Produkti ka kaluar në modalitetin e vetëmbrojtjes për shkak të një problemi me furnizimin (tensioni i linjës, presioni i ujit, etj.).	Për të anuluar programin, rrotulloni çelësin e Përzgjedhjes së Programit për të përzgjedhur një program tjetër. Programi i mëparshëm do të anulohet. Shihni seksionin "Anulimi i programit" Nëse problemi vazhdon, telefononi servisin.
E17	Në pajisje ka shkumë të tepërt pas përfundimit të ciklit.	• Ruajeni detergjentin në një vend të mbyllur dhe të thatë. Mos e ruani në vende tepër të nxehta. • Përdorni sasi më të vogla detergjenti për rroba poroze siç është tyli. • Përdorni sasi detergjenti të përshtatshme me sasinë e rrobave dhe nivelin e njollave. • Përdorni vetëm sasi të mjaftueshme detergjenti. • Sigurohuni ta vendosni detergjentin në ndarësen e duhur. • Ekzekutoni programin e Pastrimit të kazanit me pajisjen bosh. Shihni programin e“Pastrimit të kazanit Nëse pajisja juaj nuk përfshin programin e Pastrimit të kazanit, mund të përdorni Pambuk 90C. • Pasi të ekzekutoni një program të shkurtër pa detergjent, kontrolloni pajisjen. Nëse problemi vazhdon, telefononi servisin.
E18	Cikli i centrifugës nuk fillon për shkak të një çekuilibri të pajisjes.	Kontrolloni rrobat në pajisje. Sasia e rrobave mund të mos jetë e mjaftueshme. Provoni duke e shtuar sasinë e rrobave. Rrobat mund të jenë duke shkaktuar një çekuilibër; seleksionojini rrobat me dorë dhe shpërndajini në mënyrë të njëtrajtshme brenda pajisjes. Provoni përsëri në ciklin e centrifugës.
E12	Mund të ketë ujë brenda pajisjes.	Hiqni pajisjen nga priza. Mund të ketë ujë poshtë pajisjes. Pastroni ujin poshtë pajisjes. Vëreni pajisjen në prizë përsëri. Provoni të ekzekutoni një cikël të shkurtër. Nëse problemi vazhdon ose shihni se po rrjedh ujë nga një prej zorrëve, mbyllni valvulat dhe telefononi servisin.
E27	Kontrolloni shkarkimin e ujit nga pajisja.	Shihni seksionin “Lidhja e zorrës së shkarkimit me tubacionet shkarkuese”.
E84	Lidhja BLE nuk mund të vendoset.	Kontrollojeni, përpiquni ta lidhni. Shihni seksionin “Veçoria e HomeWhiz dhe Funksioni i Kontrollit në largësi”. Nëse problemi vazhdon, telefononi servisin.

DEKLARATË / PARALAJMËRIM

Disa defekte (të thjeshta) mund të trajtohen në mënyrë të përshtatshme nga përdoruesi pa lindur ndonjë problem sigurie ose përdorimi të pasigurt, me kusht që ato të kryhen brenda kufijve dhe në përputhje me udhëzimet e mëposhtme (shih pjesën "Vetë-Riparimi").

Prandaj, përveçse nëse autorizohet ndryshe në seksionin e mëposhtëm "Vetë-Riparimi", riparimet duhet të kërkohet të bëhen nga riparues profesionistë të regjistruar në mënyrë që të shmangen problemet e sigurisë. Një riparues profesionist i regjistruar është një riparues profesionist të cilit i është dhënë qasje nga prodhuesi në udhëzimet dhe listën e pjesëve të këmbimit të këtij produkti në përputhje me metodat e përshkruara në aktet legjislative në përputhje me Direktivën 2009/125/KE. **Gjithsesi, vetëm agjenti i shërbimit (d.m.th. riparuesit profesionistë të autorizuar) që mund të kontaktoni përmes numrit të telefonit të treguar në manualin e përdorimit/kartën e garancisë ose përmes shitësit tuaj të autorizuar, mund të ofrojë shërbim sipas kushteve të garancisë. Prandaj, ju lutemi kini parasysh që riparimet nga riparues profesionistë (të cilët nuk janë të autorizuar nga Beko) do ta bëjnë të pavlefshme garancinë.**

Vetë-Riparimi

Vetë-riparimi mund të bëhet nga përdoruesi në lidhje me pjesët e mëposhtme të këmbimit: dera, mentesha e derës dhe guarnicionet, guarnicionet e tjera, grupi i kyçjes së derës dhe pajisjet periferike plastike siç janë shpërndarësit e detergjentit (një listë e përditësuar disponohet edhe në support.beko.com që nga 1 Mars 2021).

Për më tepër, për të garantuar sigurinë e produktit dhe për të parandaluar rrezikun e lëndimeve serioze, vetë-riparimi i përmendur duhet të bëhet duke ndjekur udhëzimet në manualin e përdorimit për vetë-riparimin ose të cilat disponohen në support.beko.com. Për sigurinë tuaj, hiqeni nga priza produktin përpara se të bëni ndonjë vetë-riparim.

Riparimi dhe përpjekjet për riparim nga përdoruesit i pjesëve që nuk përfshihen në një listë të tillë dhe/ose duke mos ndjekur udhëzimet në manualët e përdorimit për vetë-riparimin ose të cilat janë të disponueshme në support.beko.com, mund të ngrenë çështje sigurie që nuk i atribuohen Beko-s dhe do ta bëjnë të pavlefshme garancinë e produktit.

Prandaj, rekomandohet shumë që përdoruesit të mos përpiqen të kryejnë riparime që nuk përfshihen në listën e përmendur të pjesëve të këmbimit, duke kontaktuar në raste të tilla riparues profesionistë të autorizuar ose riparues profesionistë të regjistruar. Në rast të kundërt, përpjekje të tilla nga përdoruesit mund të shkaktojnë probleme
sigurie dhe të dëmtojnë produktin dhe si pasojë mund të shkaktojnë zjarr, përmbytje, goditje elektrike dhe lëndime serioze personale.

Si shembuj, por pa u kufizuar në to, riparimet e mëposhtme duhet t'u adresohen riparuesve profesionistë të autorizuar ose riparuesve profesionistë të regjistruar: motori, grupi i pompës, skeda kryesore, skeda e motorit, skeda e ekranit, ngrohësit etj.

Prodhuesi/shitësi nuk mund të mbajë përgjegjësi në asnjë rast kur përdoruesit nuk veprojnë në përputhje me sa më sipër.

Disponueshmëria e pjesëve të këmbimit të lavatriçes ose makinës larëse-tharëse që keni blerë është 10 vjet. Gjatë kësaj periudhe do të ketë në dispozicion pjesë këmbimi origjinale që lavatriçja ose makina larëse-tharëse të funksionojnë siç duhet.

tehnoteka

https://tehnoteka.rs

Ovaj dokument je originalno proizveden i objavljen od strane proizvođača, brenda Beko, i preuzet je sa njihove zvanične stranice. S obzirom na ovu činjenicu, Tehnoteka ističe da ne preuzima odgovornost za tačnost, celovitost ili pouzdanost informacija, podataka, mišljenja, saveta ili izjava sadržanih u ovom dokumentu.

Napominjemo da Tehnoteka nema ovlašćenje da izvrši bilo kakve izmene ili dopune na ovom dokumentu, stoga nismo odgovorni za eventualne greške, propuste ili netačnosti koje se mogu naći unutar njega. Tehnoteka ne odgovara za štetu nanesenu korisnicima pri upotrebi netačnih podataka. Ukoliko imate dodatna pitanja o proizvodu, ljubazno vas molimo da kontaktirate direktno proizvođača kako biste dobili sve detaljne informacije.

Za najnovije informacije o ceni, dostupnim akcijama i tehničkim karakteristikama proizvoda koji se pominje u ovom dokumentu, molimo posetite našu stranicu klikom na sledeći link:

https://tehnoteka.rs/p/beko-masina-za-pranje-vesa-wue-6532-b0-akcija-cena/